



**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR PËR PROJEKTIN
“ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT” NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI PËRPUTHSHMËRINË

E PROJEKTIT

“ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT”, NË

MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë, më __.11.2020

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
II. HYRJA	11
1. Objekti i auditimit	11
2. Qëllimi i auditimit	11
3. Identifikimi i çështjes:	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	11
5. Përgjegjësitë e audituesve	13
6. Kriteret e vlerësimit	13
7. Standardet e auditimit	13
8. Metodatat e auditimit	14
9. Dokumentimi i auditimit	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM	15
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIVEVE TË AUDITIMIT	15
2.1 Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm	15
2.2 Mbi marrëveshjet e financimit të Projektit me Huadhënësin, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	16
2.3 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projekteve në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit	18
2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	27
2.5 Mbi zbatimin e procedurave dhe kushteve të linjës së kredisë	31
2.6 Verifikimi dhe inspektimi në lidhje me eficiencën e kredive të marra nga SME – të në përputhje me Plan – bizneset e paraqitura prej tyre	39
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	41
V. ANEKSE	52

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zyrën e PMU, Projektin ‘Zhvillimi i Sektorit Privat’ në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 287/1, datë 11.03.2020, i ndryshuar, me afat auditimi nga data 14.05.2020 deri me datë 03.07.2020, për periudhën nga 01.06.2017 deri më 30.04.2020. Auditimi u krye me përzgjedhje dhe i njëpasnjëshëm mbi bazë materialiteti dhe risku. Konkretisht u audituan, zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, marrëveshjet financiare dhe ndryshimet e tyre, shkalla e arritjes së objektivave dhe komponentëve të Programit, menaxhimi financiar i Projektit, shkalla e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt atyre të programuara dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zbatimi i procedurave në lidhje me kushtet e dhënies së kredive si dhe u krye në vazhdimësi edhe verifikimi i eficiencës së kredive të marra në përputhje me Plan – Bizneset e paraqitura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit të programit, Urdhrat e menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, akt-rakordimet me bankën, programet ekonomiko të miratuara nga Bordi i CLSC si dhe u verifikuan 90 % në vlerë dhe 80 % në numër të investimeve të kryera nga Klientët Kredimarrës. Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 12 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 03.07.2020. Me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 287/5, datë 13.07.2020, nga subjekti janë paraqitur observacionet e akteve të mbajtura. Me shkesën nr. 287/6 datë 27.07.2020 është dërguar Projektraporti i Auditimit dhe me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 287/6 prot., datë 26.08.2020 subjekti i auditimit ka paraqitur observacione për Projektraportin, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për marrjen e masave në përmirësimin e punës. Për sa i takon Takimit Përmbysës midis niveleve drejtuese të KLSH-së, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar, pas njoftimit me e-mailin e datës 25.08.2020 është njoftuar Drejtori i PMU, dhe në vijim ky takim u zhvillua me datë 01.09.2020.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Sipas korrespondencave rezulton se nuk janë marrë masa nga ana e CLSC/PMU në lidhje me programe të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve dhe njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda afatit 20 ditor. (Shiko Aneks 1.1, faqe 52 – 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se KLSH për përmirësimin e situatës ka rekomanduar: - 13 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 5 masa, 5 janë realizuar pjesërisht dhe 3 prej tyre nuk janë pranuar e zbatuar. - 7 masa për shpenzime jo në përputhje me	Faqe 15-16	E LARTË	CLSC/PMU të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin paraardhës dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara dhe të marrë masat e duhura për zbatimin e plotë brenda afateve kohore të përcaktuara.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 210,129 € , nga të cilat 4 janë zbatuar dhe 3 masa në shumën 165,629 € nuk janë pranuar e zbatuar. - 2 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar të gjitha.			
2.	Në lidhje me objektivat u konstatua se: - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e numrit të huave me afat të mesëm/të gjatë në dobi të përfutësve parësore nga ana e BTP pjesëmarrëse, krahasuar me programin PRODAPS. Gjatë programit PRODAPS janë realizuar 114 financime me një mesatare 14 financime në vit, kurse për programin IASME janë realizuar 25 financime me një mesatare 8 financime në vit. Si rrjedhojë kemi një rënie të financimeve. Gjithashtu 44 % e vlerës së financimit për periudhën objekt auditimi e kanë përfutur 4 subjekte, fakt ky i cili nuk reflekton rritje të numrit të kredi marrësve në dobi të NVM^{-ve}; - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e punësimit të grave dhe të rinjve mes NVM^{-ve} përfituese sepse nga programi i financimit PRODAPS janë krijuar mesatarisht 11 vende të reja pune për çdo financim, kurse nga programi i financimit IASME janë krijuar mesatarisht 6 vende të reja pune, nga financimet e monitoruara, pra krijimi i vendeve të reja të punës është në rënie krahasuar me programin PRODAPS. Gjithashtu nga ana e PMU/CLSC nuk ka një monitorim se sa gra dhe të rinj janë punësuar në këto vende pune të krijuara prej subjekteve të financuara nga programi; - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e NVM^{-ve} shqiptare që përfitojnë certifikime të cilësisë (ISO 9001) dhe mjedisore (ISO 14001) pasi Njësia e Menaxhimit të Programit dhe Komiteti Drejtues i Kredive (PMU/CLSC) nuk kanë monitoruar sa subjekte të financuara nga programi janë pajisur me këto certifikata dhe nuk është dhënë asnjë ndihmë, asistencë teknike dhe konsulencë, për pajisjen e tyre me këto certifikata; - <u>Është realizuar pjesërisht</u> rritja e huave nga ana e instituteve financiare pjesëmarrëse në dobi të NVM^{-ve} që ndodhen jashtë korridorit Tiranë-Durrës. Për periudhën objekt auditimi, jashtë kësaj	Faqe 18 – 27	E LARTË	2.1 CLSC/PMU të marrin masa për organizimin e fushatave promociionale për të informuar bizneset në zonat e pa zhvilluara (kjo sipas parashikimeve të bëra në pikën 5.4.5 Aktivitetet Mbështetëse të Programit, germa c Promovimi i Komponentëve të Programit), të cilat nuk kanë akses në BTP për marrje kredie, për produktet financiare që ofron programi i financimit si dhe reklamimi i materialeve promociionale në qendrat dhe institucionet që kanë kontakte të drejtpërdrejta me publikun me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të Programit. CLSC/PMU të marrin masat e nevojshme për një monitorim dhe vlerësim të thelluar të të dy programeve, PRODAPS dhe IASME duke bërë të mundur evidentimin e pengesave të lindura, në të gjitha hallkat e procesit të kredi dhënies nga BTP, përgjatë implementimit të projektit që kanë ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të parashikuara në marrëveshje. 2.2 CLSC/PMU të marrin masat e nevojshme për një monitorim dhe vlerësim të thelluar të të dy programeve, PRODAPS dhe IASME duke bërë të mundur evidentimin e pengesave të lindura, në të gjitha hallkat e procesit të kredi dhënies nga BTP, përgjatë implementimit të projektit që kanë ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të parashikuara në marrëveshje. 2.3 CLSC/PMU në bashkëpunim me ekspertin e huaj të përcaktojnë tregues të matshëm dhe të verifikueshëm që do të bëjnë të mundur evidentimin e problematikave në realizimin e objektivave të programit në kohë reale gjatë implementimit të tij.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	zone janë financuar 19 subjekte ose 76 % e totalit, ose 60 % e vlerës së financuar dhe 6 subjekte në zonën Tiranë-Durrës të cilat zënë një vlerë të konsiderueshme (40 % të vlerës së financuar). Gjithashtu nuk kemi një përfshirje të të gjitha zonave më pak të zhvilluar të vendit dhe për qarqet Vlorë, Kukës dhe Dibër nuk rezultojnë asnjë financim; -Nuk është kryer nga ana e PMU/CLSC monitorim dhe vlerësim gjatë implementimit të programit si dhe mbledhje e të dhënave në mënyrë sistematike duke i renditur ato sipas një skeme të mirë përcaktuar të cilat janë shtylla kryesore për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e treguesve të matshëm. - Nuk është analizuar raporti midis numrit të kredive mbi totalin e kredive të dhëna nga BTP dhe rritja në vlerën e shtuar të prodhimeve të përfituesve.			
3.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi 01.06.2017 deri më datën 30.04.2020 rezultojnë se: - Komponentët përbërës të kredisë nuk janë disbursuar brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje. Gjithashtu nga komponenti “Asistencë Teknike” nuk janë realizuar të gjitha parashikimet të cilat do të ndihmonin në realizimin e objektivave në tërësi të programit. - Fondi qarkullues, i krijuar nga rimbursimi i huas nga BTP, deri në datën 30.04.2020 është, nga programi PRODAPS 23,372,870.47 Euro dhe nga programi IASME 539,036.31 Euro. Nga ky fond me të njëjtin mekanizëm do të financohen projekte për NVM ndërmjet BTP bazuar në marrëveshjen “On Lending Agreement” në fuqi. Kostot e veprimtarisë, për elementët përbërës të “Asistencës Teknike”, të parashikuara në marrëveshjen e programit IASME janë për një periudhë tre vjeçare sipas afatit të disbursimit e përlogaritur mesatarisht 500,000 Euro/vit. Për sa i përket kohëzgjatjes së PRODAPS është 38 vjet, referuar nenit 4 të ligjit 9527 datë 11.05.2006 dhe për IASME është 16 vjet, referuar nenit 6 të ligjit 19/2014 datë 27.02.2014. Vihet re se të dy programet kanë një shtrirje në kohë që tejkalon planet e detajuara për menaxhimin e programit të	Faqe 18 – 27	E LARTË	3.1CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e një vendosjeje sa më të drejtë dhe të arritshme të komponentëve të programit duke ju përshtatur nevojave të projektit përgjatë kohëzgjatjes të cilësuar në marrëveshje. 3.2CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e programimit të fondeve për mbulimin e veprimtarisë për administrimin e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes së parashikuar të tij, kjo për të shmangur mosfunksionimin e veprimtarisë së PMU si zbatuese e projektit përpara përfundimit të afateve në përputhje me parashikimet e cilësuar në marrëveshje. 3.3Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë (CLSC) të marrin masa për shmangien e kontratave afatshkurtra të punës për stafin e PMU-së të cilat për rrjedhojë nuk mundësojnë një strukturë të qëndrueshme të saj dhe nuk

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<u>parashikuara në marrëveshjet e financimit, e cila ka parashikuar të jetë 3 vjet. Nga ana e organeve drejtuese e menaxhuese të programit, MFE, CLSC, PMU dhe Njësive Lokale të huadhënësit nuk janë përgatitur plane financimi që do të mundësojnë menaxhimin e programit përgjatë kohëzgjatjes së parashikuar.</u>			motivojnë stafin për përmbushjen e objektivave të programit.
4.	Në 22 raste janë aplikuar nga Bankat e Ndërmjetme komisione për kryerjen e shpenzime bankare, apo komisione për disbursimin e kredisë në përqindje të ndryshme të cilat variojnë nga 0.5 % deri në 10 %. Në fakt këto janë aplikuar në dëm të Klientëve në kundërshtim me marrëveshjen On Lending Agreement pasi këto komisione janë marrë përsipër nga Banka e Ndërmjetme e si të tilla janë detyrim i tyre dhe jo i kredimarrësve. Për rrjedhojë rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet shuma prej të paktën 31,070 € dhe 798,750 lekë të fondeve të Programit nga ana e Bankave sipas tabelës së përshkruar në Aneksin nr. 5.1, faqe 56 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.	Faqe 31 – 39	E LARTË	CLSC/PMU të marrin masat e duhura për shmangien e aplikimeve të komisioneve të tilla në ngarkim të kredimarrësve siç janë ato të shumave prej 31,070 € dhe 798,750 lekë nga Bankat e përshkruara sipas tabelës në Aneks 5.1, faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim përdorimin e fondeve të Programit vetëm për përmbushjen e objektivave të parashikuara në marrëveshje.
5.	Në 5 raste ndaj Bankave të Ndërmjetme nuk janë aplikuar penalitetet në shumën 38,520 € për mangësitë e konstatuara përgjatë dosjeve të kredive të dhëna ndaj subjekteve kredimarrëse sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.	Faqe 31 – 39	E LARTË	CLSC/PMU të marrin masat e duhura për arkëtimin e shumës prej 38,520 € nga Bankat sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit nëpërmjet aplikimit të penaliteteve ndaj Bankave të Ndërmjetme.
6.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 5 raste nuk janë marrë masa për evidentimin e mangësive dhe më pas kthimin pas të shumës së mbetur nga kreditë e dhëna në shumën totale prej 1,234,000 € për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se: 1. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme F. B. tek Klienti B. A. I. (shuma për kthim në masën 500,000 €)</u> - Nuk konfirmohet origjina italiane për 7 furnitorë të Klientit; - Për 5 furnitorë (nga këta 7 si më sipër) nuk konfirmohen dokumentet e zhdoganimit të materialeve;	Faqe 31 – 39	E LARTË	CLSC/PMU të marrë masa për respektimin e kriterëve të vendosura në lidhje me praktikën e dhënies së kredive dhe kthimin pas të shumave të tyre në rastet e shkeljes së kushteve të Marrëveshjes On Lending Agreement me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e Programit siç është rasti i mësipërm për 5 subjektet në shumën 1,234,000 € sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 57 e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	2. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme C. tek Klienti I. N. F. (shuma për kthim 500,000 €)</u> Nga të gjitha shpenzimet justifikuese rezultojnë se me shkresën e administruar në PMU me nr. 36 prot., datë 05.05.2020 janë dorëzuar: - Faturat tatimore; - Deklaratat për zhdoganimin e makinerive dhe pajisjeve; - Swift pagesat në shumën 200,000 €; - Swift pagesat në shumën 300,000 €; Materialet e mësipërme rezultojnë se janë sjellë përtej afati 18 muaj nga data e disbursimit të kredisë. 3. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. G. (shuma për kthim 50,000 €)</u> - Deri në fund të afatit të parashikuar në marrëveshjen “<i>On lending Agreement</i>” nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit justifikues të pagesës së kryer në favor të Klientit. 4. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme T. B. tek Klienti E. (shuma për kthim 164,000 €)</u> - I gjithë investimi i kryer, referuar faturave dhe deklaratave doganore për blerjen e makinerive në shumën 135,520 Euro, e ka me origjinë Zvicëranë dhe jo me origjinë Italiane, dhe blerja e makinerive dhe pjesëve është bërë në Zvicër dhe jo sipas parashikimeve të bëra në marrëveshjen “<i>On lending Agreement</i>”; 5. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. D. (shuma për kthim 70,000 €)</u> - Një prej faturave tatimore në shumën 66,790 € përmban shpenzime në shumën 16,667 € për blerje të kryera përpara datës së disbursimit të kredisë dhe si e tillë nuk duhet të merret në konsideratë si justifikim për fondet e Programit; - Një prej faturave tatimore me vlerë 999,810 lekë ose 7,680 € është përdorur për mbulimin e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit; Një prej faturave tatimore me vlerë 960,000 lekë është përdorur për mbulimin			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit;			
7.	Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të Kredi marrësve rezultoi se në 11 raste janë financuar nga Programi shuma prej 1,114,134 € sipas listës së përshkruar në Aneks 5.4, faqe 57 e Raportit Përfundimtar të Auditimit për subjekte kredi marrës të cilësuar si <i>Mikrondërmarrje</i> , kur në fakt objekt financimi i këtij Programi kanë qenë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – të). Sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshjen e Financimit Mikrondërmarrjet, Ndërmarrjet e Vogla dhe ato të Mesme klasifikohen si të tilla në bazë të numrit të punëtorëve, përkatësisht, 1-9, 10-49 dhe 50 – 249. Në fakt rezultoi se për këto 11 subjekte shuma e mësipërme prej 1,114,134 € është përdorur për të financuar projekte për ndërmarrje me 1-9 të punësuar. Konkretisht lista e këtyre subjekteve paraqitet sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.4, faqe 56 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.	Faqe 31 – 39	E LARTË	CLSC/PMU të marrin masa për financimin e Projekteve të Kredi marrësve që janë objekt i Marrëveshjes së Financimit, konkretisht Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe jo Mikrondërmarrjet me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve të Programit siç është ai i 11 Projekteve me shumë totale 1,114,134 € të përshkruar sipas tabelës në Aneks 5.4, faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Ne kemi përfunduar auditimin e përputhshmërisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me Projektin “Zhvillimi i Sektorit Privat” për periudhën nga data 01.06.2017 deri 30.04.2020. Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Projektit ‘Zhvillimi i Sektorit Privat’, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi dhe Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000¹ dhe 4100².

Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Zyra e PMU – së, CSLC si struktura të ngarkuara me menaxhimin dhe implementimin e Projektit, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera

¹ **ISSAI 4000** - Objektivi i auditimit në sektorin publik, është të vlerësojë nëse aktivitetet e subjekteve të sektorit publik janë në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. Kjo përfshin Raportimin për shkallën në të cilën subjekti i audituar përputhet me kriteret.

² **ISSAI 4100** – Objektivi i auditimit të përputhshmërisë është

- Të sigurojë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të konkluduar nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje, për të gjitha aspektet materiale, me një set të veçantë kriteresh;
- Raportimi gjetjeve dhe konkluzioneve Kuvendit dhe/apo autoriteteve të tjera sipas rastit.

etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se mbi implementimin e rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan raste të devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të Audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura që kryesisht konsistojnë në drejtim të realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit, menaxhimit financiar të projektit dhe zbatimit të procedurave të linjës së kredisë. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë.

Opinionit auditimit: Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 4000 dhe 4100, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zyra e PMU – së, për Projektin ‘Zhvillimi i Sektorit Privat’, u konstatuan devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **opinionit të kualifikuar**.

Përgjegjësitë e menaxhimit të CLSC/PMU janë:

CLSC: Supervizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të Programit; Vendosja e rregullave dhe procedurave operative për zbatimin e Programit; Vendosja e kriterëve për pranueshmërinë e NVM (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme) për financimin e Programit; Vendosja e kriterëve të përparësisë ose financimin e Programit; Vendosja e kriterëve për pranueshmërinë e Bankave Tregtare Private (BTP) që marrin pjesë në Program; Kontrolli që kushtet për aplikim në Programi të jenë tërheqëse për NVM dhe PCB; Monitorimi i zbatimit të Programit; Monitorimi i ndikimit të Programit në tregun vendor dhe aprovimi i masave përkatëse; Emërimi i Drejtorit të PMU; Miratimi i Manualit Operacional dhe Marrëveshjes mes Huadhënësit me PCB; Miratimi i skemës së administrimit të Fondit të Garancisë Shqiptare (AGF); Miratimi i Bordit teknik të AGF; Miratimi i termave dhe kushteve të ndihmës së drejtpërdrejtë për NVM-të, përmes Programit të Ndihmës së Biznesit; Vendosja e sanksioneve ndaj PCB-ve në rast të shkeljeve të Marrëveshjes së Huadhënies; Pranimin, rishikimin dhe aprovimi i raporteve nga Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU) në lidhje me rezultatet dhe rezultatet e aktiviteteve të Programit; Miratimin e planit vjetor të punës dhe buxhetit të përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU); Shqyrtimi i gjetjeve të raporteve përmbledhëse të auditimit të konsoliduara nga Shoqëria e Auditimit.

PMU: Koordinimi dhe zbatimi i programit; Asistencë ndaj MEDTTE në arritjen e rezultateve të pritura të Programit; Asistencë ndaj MEDTTE për përcaktimin e marrëveshjeve me organet kompetente dhe për nënshkrimin e kontratave të lidhura sipas procedurave dhe modaliteteve të parashikuara në Marrëveshjen Financiare; Asistencë ndaj MEDTTE në administrimin dhe zbatimin e kredisë së butë në përputhje me Marrëveshjen Financiare të Programit; Asistencë ndaj CLSC në mbikëqyrjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Programit; Vepron si Sekretariat i CLSC; Menaxhimi i të gjitha kontratave të lidhura mes MEDTTE dhe Bankave Tregtare Private; Monitorimi i zbatimit të Linjës së Kredisë, Fondit të Garancisë dhe Fondit të Asistencës Teknike; Dhënia e asistencës teknike MEDTTE dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në forcimin e kapaciteteve në politikën e NVM-ve; Dhënia e asistencës

teknike të drejtpërdrejtë NVM-ve shqiptare përmes Programit të Mbështetjes së Biznesit, në mënyrë që të lehtësohet qasja në lehtësirat financiare të ofruara nga Programi; Dhënia e asistencës teknike shoqatave të biznesit publik dhe privat, në mënyrë që të mbështesin krijimin dhe forcimin e shoqatave të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve të NVM; Menaxhimi financiar i programit; Koordinimi me të gjitha palët e interesit në nivel lokal dhe kombëtar; Sigurimi dhe mbledhja në kohë e të gjitha të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për të lehtësuar monitorimin e Programit; Promovimi i përbërësve të programit midis NVM-ve, shoqatave të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve të NVM-ve; Përgatitja e planit vjetor të punës dhe buxhetit dhe dorëzimi në CLSC; Përgatitja e raporteve tremujore dhe vjetore të konsoliduara dhe paraqitja në CLSC në përputhje me udhëzimet; Paraqitja e Raportit Financiar të Audituar të certifikuar nga Kompania e Auditimit në CLSC për miratim, që MEDTTE duhet t'i transmetojë MAECI/DGCS dhe C. D. P. gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit që nga data e disbursimit; etj.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomalitë materiale si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të shoqërisë. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 287/1, datë 11.03.2020, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.03.2020 deri me datë 03.07.2020, në subjektin “*Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Projekti ‘Zhvillimi i Sektorit Privat’*”, për periudhën nga data 01.06.2017 deri më 30.04.2020, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **J. H., Përgjegjës Grupi**
2. **E. M., Auditues**
3. **A. A., Auditues**
4. **S. H., Auditues**

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që CLSC (*Credit Line Steering Comitee – Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë*) / PMU (*Program Management Unit – Njësia e Menaxhimit të Programit*) ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të Marrëveshjeve Financiare si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim **promovimin e përgjegjshmërisë** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes:

CLSC, zyra e PMU duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të shërbimit të ofruar nga Projekti duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

CLSC ka si përgjegjësi kryesore të saj:

- Supervizimi i eficiencës dhe efektivitetit të Programit;
- Vendosja e rregullave dhe procedurave operative për zbatimin e Programit;
- Vendosja e kriterëve për pranueshmërinë e NVM (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme) për financimin e Programit
- Vendosja e kriterëve të përparësisë ose financimin e Programit;
- Vendosja e kriterëve për pranueshmërinë e Bankave Tregtare Private (BTP) që marrin pjesë në Program;
- Kontrolli që kushtet për aplikim në Programi të jenë tërheqëse për NVM dhe PCB;
- Monitorimi i zbatimit të Programit;
- Monitorimi i ndikimit të Programit në tregun vendor dhe aprovimi i masave përkatëse;
- Emërimi i Drejtorit të PMU;

- Miratimi i Manualit Operacional dhe Marrëveshjes mes Huadhënësit me PCB;
- Miratimi i skemës së administrimit të Fondit të Garancisë Shqiptare (AGF);
- Miratimi i Bordit teknik të AGF;
- Miratimi i termave dhe kushteve të ndihmës së drejtpërdrejtë për NVM-të, përmes Programit të Ndihmës së Biznesit;
- Vendosja e sanksioneve ndaj PCB-ve në rast të shkeljeve të Marrëveshjes së Huadhënies;
- Pranimin, rishikimin dhe aprovimi i raporteve nga Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU)
- në lidhje me rezultatet dhe rezultatet e aktiviteteve të Programit;
- Miratimin e planit vjetor të punës dhe buxhetit të përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU);
- Shqyrtimi i gjetjeve të raporteve përmbledhëse të auditimit të konsoliduara nga Shoqëria e Auditimit;

PMU ka si përgjegjësi kryesore të saj:

- Koordinimi dhe zbatimi i programit;
- Asistencë ndaj MEDTTE në arritjen e rezultateve të pritura të Programit;
- Asistencë ndaj MEDTTE për përcaktimin e marrëveshjeve me organet kompetente dhe për nënshkrimin e kontratave të lidhura sipas procedurave dhe modaliteteve të parashikuara në Marrëveshjen Financiare;
- Asistencë ndaj MEDTTE në administrimin dhe zbatimin e kredisë së butë në përputhje me Marrëveshjen Financiare të Programit;
- Asistencë ndaj CLSC në mbikëqyrjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Programit; Vepron si Sekretariat i CLSC;
- Menaxhimi i të gjitha kontratave të lidhura mes MEDTTE dhe Bankave Tregtare Private;
- Monitorimi i zbatimit të Linjës së Kredisë, Fondit të Garancisë dhe Fondit të Asistencës Teknike;
- Dhënia e asistencës teknike MEDTTE dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në forcimin e kapaciteteve në politikën e NVM-ve;
- Dhënia e asistencës teknike të drejtpërdrejtë NVM-ve shqiptare përmes Programit të Mbështetjes së Biznesit, në mënyrë që të lehtësohet qasja në lehtësirat financiare të ofruara nga Programi;
- Dhënia e asistencës teknike shoqatave të biznesit publik dhe privat, në mënyrë që të mbështesin krijimin dhe forcimin e shoqatave të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve të NVM;
- Menaxhimi financiar i programit;
- Koordinimi me të gjitha palët e interesit në nivel lokal dhe kombëtar;
- Sigurimi dhe mbledhja në kohë e të gjitha të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për të lehtësuar monitorimin e Programit;
- Promovimi i përbërësve të programit midis NVM-ve, shoqatave të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve të NVM-ve;
- Përgatitja e planit vjetor të punës dhe buxhetit dhe dorëzimi në CLSC;
- Përgatitja e raporteve tremujore dhe vjetore të konsoliduara dhe paraqitja në CLSC në përputhje me udhëzimet;
- Paraqitja e Raportit Financiar të Audituar të certifikuar nga Kompania e Auditimit në CLSC për miratim, që MEDTTE duhet t'i transmetojë MAECI/DGCS dhe C. D. P. gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit që nga data e disbursimit;

- Informimi i CLSC për çdo ndryshim në kontekstin kombëtar ekonomik në lidhje me zbatimin e Programit, në mënyrë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme korrigjuese të nevojshme për të mbajtur ose përmirësuar progresin e programit;

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9527, datë 11.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e Programit për Zhvillimin e Sektorit Privat, me anën e një kredie ndihme për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”, Ligji nr. 9528, datë 11.5.2006 “Për Ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe A. s.p.a. për Programin e Zhvillimit të Sektorit Privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”, Ligji nr. 147/2013 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe A. s.p.a. për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare”*; Ligji nr. 19/2014 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e “Programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare”*; Ligji nr. 8957 datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Rregulloren e Brendshme të PMU/CLSC (Manuali Operacional); etj.

7. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ☐ **ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ☐ **ISSAI (400)** “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parime themelore ISSAI (100) dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ☐ **ISSAI (4000)** “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- ☐ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- ☐ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t,
- ☐ INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;

8. Metodat e auditimit

□ Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

□ Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

□ Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Strukturat e ngarkuara për drejtimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e Programit janë:

- Ministria e Ekonomisë Shqiptare, sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) e cila duhet të zbatojë Programin dhe rregullon marrëveshjet e nevojshme me entet kompetente të nënshkruajë kontratat e kërkuara dhe do të jetë përgjegjëse për përdorimin e fondeve dhe kredisë ndihmë, për menaxhimin e fondit rotativ, shlyerjen e kredisë sipas modaliteteve dhe procedurave të vendosura në Marrëveshjen financiare; Do të lidhë Marrëveshjen financiare me organizmin e caktuar nga Qeveria Italiane për të lidhur këtë marrëveshje;
- Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë (CLSC) do të mbikëqyrë efikasitetin dhe efektivitetin e Programit. CLSC do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shqiptare që marrin pjesë në realizimin e këtij Programi dhe nga përfaqësues të DPBZH dhe Ambasadës Italiane. Nga auditimi u konstatua se CLSC është krijuar më datë 12.05.2008 dhe përbëhet nga pesë anëtar të cilët janë; një përfaqësues i Ambasadës Italiane, dy përfaqësues nga MFE, një përfaqësues i Zyrës së Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Italian dhe një përfaqësues nga Bankën e Shqipërisë (BSH).
- Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) do të përbëhet nga personeli i METE (sot MFE) do të mbetet operative gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit dhe do të ketë si detyrë asistimin e të gjitha organeve të lartpërmendura në drejtimin e Programit, duke garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Marrëveshje. Aktualisht PMU përbëhet nga 6 përfaqësues të palës shqiptare, drejtori i Programit, specialistja e financës, asistentja/sekretare, menaxhere komunikimi dhe informimi, specialist prokurimesh dhe një shofer. Kontratat e punës janë kontrata “Me kohë të pjesshme pune”, me afat një 3 muor me të drejtë rinovimi.
- Bankat Tregtare Private (BTP), që aderojnë në drejtimin e linjës së kreditit me anë të “*On-lending agreement*” japin kredi për NVM, të cilat do të përfitojnë nga huat e dhëna nga BTP nga linja e kredisë. Kredia ndihmë përdoret për financimin e projekteve të NVM nëpërmjet një grupi të përcaktuar BTP, me të cilat MFE ka nënshkruar marrëveshjen “*On Lending Agreement*”.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është kryer auditimi i mëparshëm në bazë të programit të auditimit të miratuar nr. 610/1 prot., datë 03.06.2017 me objekt: “*Përputhshmërie në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Projekti Zhvillimi i Sektorit Privat*” për periudhën 01.01.2013 deri më 31.05.2017. Me shkresën nr. 610/9 prot., datë 26.09.2017, administruar në MFE me nr. 13240 prot., datë 27.09.2017, në bazë të Vendimit të Kryetarit të KLSH – së nr. 117 datë 26.09.2017, është dërguar Shkresa Përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet për Projektin “*Zhvillimi i Sektorit Privat*”.

Titulli i gjetjes:	CLSC/PMU, nuk ka zbatuar dhe realizuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.
Situata:	Sipas korrespondencave rezulton se nuk janë marrë masa nga ana e CLSC/PMU në lidhje me programe të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve dhe njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda afatit 20 ditor. (<i>Shiko Aneks 1.1, faqe 51 – 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>). Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se KLSH për përmirësimin e situatës ka rekomanduar: - 13 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 5 masa, 5 janë realizuar pjesërisht dhe 3 prej tyre nuk janë pranuar e zbatuar.

	-7 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 210,129 € , nga të cilat 4 janë zbatuar dhe 3 masa në shumën 165,629 € nuk janë pranuar e zbatuar. - 2 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar të gjitha. (Shiko Aneks 1.1, faqe 52 - 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c, ku përcaktohet se: “Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:c) t’u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrativ”.
Ndikimi:	Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ka ndikuar në përsëritjen e mangësive edhe për periudhën objekt auditimi.
Shkaku	Mos marrja në konsideratë e të gjitha rekomandimeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të Programit CLSC/PMU të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të evidentojnë përgjegjësit për mos zbatimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi CLSC dhe Drejtori i PMU.

Për sa më sipër subjekti i audituar, me shkresën nr. 4816/16 prot., datë 26.08.2020, administruar në KLSH me nr. 287/7, prot., datë 27.08.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:
“Lidhur me rekomandimin 2.2, procedura po ndiqet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe jemi në pritje të VKM i cili menjëherë do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Shqipërisë...
Lidhur me rekomandimin 9.1 sqarojmë se CLSC ka reflektuar në Manualin Operacional kushtet e ndikimit në mjedis dhe pikërisht në marrëveshjen e Huas e cila është pjesë integrale e Manualit Operacional, në Aneksin nr. 2 “Kriteret prioritare” janë vendosur si kriter prioritar projektet me ‘Prodhime të pastra dhe projekte të zvogëlimit të ndotjes’.
Lidhur me rekomandimin 11.1 sqarojmë se marrëveshja e huas OLA nuk përmban afate për monitorimin e subjekteve të financuara.
Lidhur me rekomandimin 2.1, 3.1 dhe 5.1 sqarojmë se, PMU ka prezantuar në CLSC në mbledhjen nr. 35, datë 31.07.2018 projektet me probleme, si dhe në mbledhjen nr. 40 të CLSC datë 13.02.2020, pika 3 e axhendës projektet me probleme. CLSC vendosi ti marrë në shqyrtim mbledhjen e radhës. Minutat e të dy mbledhjeve ju janë dërguar zyrtarisht me observacionin e PMU mbi aktverifikimet e auditit”.
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:
 Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2.2 Mbi marrëveshjet e financimit të Projektit me Huadhënësin, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Titulli i gjetjes	Ndryshimi i Marrëveshjes së Financimit nuk është miratuar me ligj por vetëm në parim.
--------------------------	---

Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se pas bllokimit të fondeve të CDP (C. D. P.) nga Gjykata e Romës të të gjitha fondeve dhe të gjitha disbursimet në llogaritë e hapura jashtë territorit italian, me datë 12.11.2018 i është dërguar një MEMO Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nga ana e NJMP ku është kërkuar shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve të akorduara për këtë projekt. Afati i fundit i disbursimeve ka qenë data 18.12.2018 dhe deri me datë 12.11.2018 kanë rezultuar ende 8 milion euro të pa disbursuara. Në datën 13.11.2018 Ministri i Financës dhe Ekonomisë i ka dërguar shkresën nr. 340 prot. mbi nevojën e kërkesës për shtyrjen e afatit të disbursimit të fondeve të programit IASME. Në datën 15.11.2018 Ministri i Financës dhe Ekonomisë i ka dërguar C. D. P. shkresën nr. 20467 prot, ku i ka kërkuar shtyrjen me 12 muaj të afatit të disbursimit të fondeve C. D. P. ka kthyer përgjigje me datë 26.11.2018 ku ka pranuar shtyrjen e afatit me 12 muaj të disbursimit të fondeve. Në datën 17.12.2019 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar shkresën nr. 21446 <i>‘Për mendim këshillor’</i> Avokaturës së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi Projekt-Vendimin <i>“Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , dhe A. S.P.A, për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare ratifikuar me ligjin nr. 147/2013”</i>. Në këtë Projekt-Vendim kërkohet shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve deri me datë 31.12.2021 si edhe shtyrja e afatit të përdorimit të fondeve të dedikuara për asistencë teknike deri më 30.04.2022. Në datën 26.12.2019 dhe në datën 13.02.2020 Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë mbi ndryshimet që duhen të bëhen në këtë marrëveshje si edhe rrugën ligjore që duhet të ndiqet për ta bërë këtë ndryshim duke i rekomanduar MFE që të veprohet konform ligjit nr. 43/2016 <i>“Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”</i>. Në datën 13.01.2020 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë mbi ndryshimet e propozuara që duhen të bëhen në këtë marrëveshje. Ministria e Financës dhe Ekonomisë pas përgjigjeve të marra nga këto institucione dhe ndryshimeve të propozuara ka riformuluar disa pika të Projekt-Vendimit. Megjithatë në datën 13.02.2020 Ministria e Drejtësisë ka shprehur dhe njëherë mosdakordësinë e saj për disa pika të Projekt-Vendimit. Pas ndryshimeve përfundimtare të pasqyruara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, ky Projekt –Vendim është miratuar në parim nga Kryeministri i Shqipërisë, por ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave çka bën që kjo shtyrje e afateve të disbursimit të fondeve dhe afatit të përdorimit të fondeve për asistencën teknike mos ti jetë paraqitur ende C. D. P.. Fakti që afati i përdorimit të fondeve për asistencë teknike ka përfunduar dhe shtyrja e tij ende nuk është zyrtarizuar ka bërë që shpenzimet e kryera për asistencën teknike janë paguar nga të ardhurat e përfituara prej penaliteteve nga Marrëveshja Financiare prej 27.5 milion euro e nënshkruar ndërmjet MF dhe A. S.P.A më datë 24.02.2006 dhe është ratifikuar në Parlament me ligjin nr. 9528, datë
------------------------	---

	11.05.2006.
Kriteri:	Marrëveshja e financimit të projektit IASME e ratifikuar në parlament me ligjin nr. 147/2013, “Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e NMV-ve Shqiptare”, neni 9, pika 9.6.
Ndikimi:	Ky projekt aktualisht po funksionon duke u bazuar mbi të ardhurat e realizuara nga penalitetet në Marrëveshjen PRODAPS. Nëse nuk arrihet sa më shpejt ndryshimi i marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe C. D. P. ky projekt rrezikon mbylljen e tij.
Shkaku	Mos miratimi i ndryshimeve të marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e PMU-së të vihet dhe njëherë në vëmendje rëndësia e ndryshimit të kësaj marrëveshje sa më shpejt për të mos rrezikuar mbylljen e këtij Programi Financimi i cili i ka ardhur në ndihmë ndërmarrjeve të vogla e të mesme shqiptare.

2.3 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projekteve në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Me Ligjin Nr. 19, 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” është bërë ratifikimi i kësaj marrëveshje për një shumë të përgjithshme prej 51 milionë eurosh për trevjeçarin 2010 – 2012, prej të cilave 15 milionë euro janë të destinuara për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat shqiptar. “Programi i ndihmës së integruar për zhvillimin e NVM-ve shqiptare”, (PROGRAMI) synon të vijoje me angazhimin e Programit për Zhvillim të NVM-ve shqiptare (PRODAPS) (nr. AID 7961/03), duke përtërirë mjetet financiare që fillimisht parashikoheshin prej tij (Linja e Kredisë prej 25 milionë eurosh dhe Fondi i Garancisë prej 2.5 milionë eurosh) e duke i plotësuar ato me një përbërës të Asistencës Teknike ndaj sipërmarrjeve, shoqatave të kategorisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Objekti i përgjithshëm i PROGRAMIT është të ndihmojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë nga pikëpamja e integritit në tregun e përbashkët evropian, duke mbështetur zhvillimin e gjerë të sipërmarrjes vendase dhe duke nxitur njëkohësisht zbatimin e standardeve të qëndrueshme mjedisore, si dhe përmirësimin në përgjithësi të kushteve të punës. Si tregues objektivisht të verifikueshëm janë përcaktuar:

- Ndikim pozitiv i të dhënave të programit në PBB kombëtar;
- Të ndihmojë në rritjen e shkëmbimit tregtar me BE-në, krahasuar me vitin e fillimit të nismës;
- Të ndihmojë në rritjen e nivelit të punësimit kombëtar, krahasuar me vitin e fillimit të nismës.

Përfutuese të PROGRAMIT në radhë të parë, janë sipërmarrjet e vogla e të mesme shqiptare, të nënkuptuara si entitete të veçanta prodhuese (sipas disiplinës legjislative shqiptare) apo në forma të grupuara (konsorciume, kooperativa, shoqata) në një raport të balancuar mes zonave qendrore dhe zonave periferike të vendit. PROGRAMI parashikon, gjithashtu, asistencë për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) për përcaktimin dhe projektimin e modeleve të zhvillimit për NVM-të shqiptare.

Duke patur parasysh që Programi IASME është *një vazhdim i programit PRODAPS* dhe synon përmirësimin e rezultateve të tij, për sa i përket ndikimit, instrumentet e Programit të ri tentojnë të favorizojnë kategori të caktuara sipërmarrjesh, sipas kritereve të qëndrueshmërisë shoqërore dhe mjedisore, ndër të cilat:

- Kushte pune në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjetikës në procesin prodhues;
- Projekte investimi që parashikojnë transferimin e teknologjive, me qëllim reduktimin e nxjerrjeve të lëndëve ndotëse apo përmirësimin e eficiencës energjetike në procesin prodhues;
- Sipërmarrje që investojnë në risitë e prodhimit apo të procesit me qëllim rritjen e nivelit të prodhimit dhe të vlerës së shtuar të të mirave, që vlerësojnë potencialet dhe prirjet vendase në kuadër të planeve të përbashkëta të zhvillimit rajonal (aty ku ekzistojnë) e që ndihmojnë në rritjen e nivelit të punësimit.

Po kështu, konsiderohen si përfituese parësore sipërmarrjet që veprojnë në sektorin agroindustrial, për pasojë, duhet të konsiderohen parësore projektet e investimit që bëjnë të mundur prodhimin e të mirave me një vlerë më të madhe të shtuar në këtë sektor.

Objektivat e veçanta të programit janë:

1. Përmirësimi i marrëdhënies së besimit mes NVM-ve shqiptare dhe sistemit bankar vendas, duke e nënkuptuar aksesin në kredi si një mjet funksional për të favorizuar rritjen e gjerë të sipërmarrjes, krijimin e ndërmarrjeve të reja, si dhe për të favorizuar inovacionin e procesit dhe të prodhimit.

2. Mbështetja e praktikave që lidhen me përgjegjësinë shoqërore, e nënkuptuar si strukturë prodhuese që sjell një ndikim pozitiv në vend për sa i përket aspektit të punësimit, mjedisit dhe atij shoqëror në përgjithësi, duke favorizuar njëkohësisht grupimet funksionale mes NVM-ve, për një zhvillim ekonomik e shoqëror më të gjerë.

Për periudhën objekt auditimi, janë financuar në total 27 NVM, dy nga programi PRODAPS me vlerë totale financimi 285,000 Euro dhe 25 nga programi IASME me vlerë totale financimi 4,427,134 Euro, ose 40 % e kredisë.

Financimi i projekteve për NVM është parashikuar të bëhet nga BTP, ndërmjet linjës së kredisë, me të cilat METE (sot MFE) para fillimit të veprimtarisë së programit duhet të nënshkruajë marrëveshjen “*On Lending Agreement*” me këto banka. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë në treg operojnë 12 banka private dhe 31 subjekte financiare jo banka, nga ku jo të gjitha subjektet financiare jo banka kanë si objekt veprimtarie dhënien e kredive. Marrëveshja financiare “*On Lending Agreement*” për programin IASME me BTP është finalizuar datë 30.06.2017 dhe është nënshkruar me 8 (tetë) banka dhe 3 (tre) subjekte financiare jo banka në total me 11 institucione financiare. Për periudhën objekt auditimi, 4 (katër) banka dhe 3 (tre) subjekte financiare jo banka, ndërmjet linjës së kredisë kanë financuar 25 projekte për 23 subjekte. Subjekti “E. T. shpk” është financuar për tre projekte. Konstatohet se dy banka janë më aktivet në dhënien e kredive, konkretisht Banka C. ka kredituar 40 % të projekteve ose 50 % të vlerës totale të financimit dhe I. S. P. Bankë. 24 % të projekteve ose 28 % të vlerës totale të financimit. Projektet e financuara nga secila bankë dhe vlera totale e kredive si më poshtë:

Projektet e Financuara			
Banka	Nr. Kredive	Vlera (Euro)	%
C.	10	2,211,564	50
F. I.	2	33,370	1
F. B.	1	500,000	11
I. S. P.	6	1,244,200	28

N.	3	93,000	2
T.	1	164,000	4
U. B.	2	181,000	4
Totali	25	4,427,134	100

Burimi: Të dhëna nga Njësia e Menaxhimit të Programit.

Nga sa më sipër vihet re se, nga 11 marrëveshjet “On Lending Agreement” të lidhura me institucionet financiare janë aktive në program 7 prej tyre. Pavarësisht rishikimit të marrëveshjes “On Lending Agreement”, të përdorur në programit PRODAPS, numri i BTP pjesëmarrëse vazhdon të jetë i ulët, kjo vjen si rezultat se Njësia e Zbatimit të Programit (PMU) dhe Komiteti Drejtues i Kredive (CLSC) si organi mbikëqyrës nuk kanë marrë masa për të nxitur BTP për të qenë më aktive në program dhe përfshirjen e atyre që nuk kanë dhënë asnjë financim nga programi.

Në objektivat e veçanta janë:

- “Rritja e numrit të huave me afat të mesëm/të gjatë në dobi të përfutësve parësore nga ana e BTP pjesëmarrëse, krahasuar me atë të lëvruara në bazë të mjeteve financiare të nismës PRODAPS”; - “Rritja e numrit të NVM-ve të regjistruara në Shqipëri prej fillimit të ndërhyrjes”. Ky është një tregues subjektiv, në numrin e NVM të regjistruara janë edhe ato që nuk financohen nga programi; - “Rritja e nivelit të importimit të pajisjeve me përmbajtje të lartë teknologjike, krahasuar me të dhënat e regjistruara prej fillimit të nismës PRODAPS”. Nga verifikimet e kryera rezultoi se të gjitha pajisjet e financuara nga projekti janë të një teknologjie të lartë.
- “Rritja e numrit të sipërmarrjeve që veprojnë në sistem apo në konsorciume prej fillimit të ndërhyrjes”; - “Rritja e punësimit të grave dhe të rinjve mes NVM-ve përfutëse”.
- “Rritja e NVM-ve shqiptare që përfitojnë certifikime të cilësisë (ISO 9001) dhe mjedisore (ISO 14001”.

b. Mbi realizimin e komponentëve (elementëve) të Programit.

Programi është parashikuar të realizohet nëpërmjet një kredie ndihme prej 15 milionë eurosh, e ndarë në tri komponentë (elementë) përbërës:

- Linja e Kredisë (11 milionë euro, prej të cilave 3.5 milionë euro për projektet e vogla);
- Fondi i Garancisë (2.5 milionë euro);
- Asistenca Teknike (1.5 milionë euro).

Për sa i përket elementit të Asistencës Teknike, financimi do të ndahet në pesë veprimtari të ndryshme, sikurse vijon:

Elementet përbërës	Veprimtaria	Kostot e veprimtarisë	Kredi-ndihmë (euro)
1. Linja e Kredisë	Hua në dobi të NVM-ve të livruara nga BTP-ja dhe IF-ja		11.000.000,00
2. Fondi i Garancisë	Mbulim i pjesshëm i rrezikut që lidhet me huat në dobi të NVM-ve		2.500.000,00
3. Asistenca Teknike			1.500.000,00
	3.1 Asistencë për NVM-të	600.000,00	
	3.2 Asistencë për shoqatat e kategorisë	90.000,00	
	3.3 Asistencë për METE-n dhe AIDA-n	90.000,00	
	3.4 Veprimtari për administrimin e Programit	360.000,00	
	3.5 Veprimtari mbështetëse	360.000,00	
Shuma e përgjithshme			15.000.000,00

Nga auditimi rezultoi se marrëveshja financiare e kësaj kredie është bërë efektive në 08.10.2015 ndërsa kërkesa për disbursim fondesh është bërë me shkresën Nr. 8076 Prot. datë 23.10.2015 dhe

shkresën Nr. 8076/1 Prot. datë 26.10.2015. Transferimi i fondeve nga A. Bankë në Bankën e Shqipërisë dhe bankën e nivelit të dytë tregohet në tabelën e mëposhtme, sipas komponentëve të programit:

	Banka e Shqipërisë		Banka Intesa Sanpaolo		Vlera e disbursuar (Euro) 30.04.2020	Gjendja (Euro) 30.04.2020
	Data	Vlera (Euro)	Data	Vlera (Euro)		
Transhi I	18.12.2015	5,500,000	30.04.2016	5,499,950	4,427,134	1,072,816
Transhi II	-	-	-	-	-	-
Asistenca teknike	18.12.2015	1,500,000	30.04.2016	1,500,000	576,280	923,720
Fondi garancisë	-	-	-	-	-	-

Burimi: Të dhëna nga Njësia e Menaxhimit të Programit.

Nga sa më sipër konstatohet se transhi i II i linjës së kredisë dhe transhi i fondit të garancisë nuk janë transferuar nga huadhënësi deri në fund të periudhës objekt auditimi.

Komponentët e programit, plan-fakt, si më poshtë:

Veprimtaria	Plani (Euro)		Fakti (Euro)		Balanca 30.04.2020
1. Linja e Kredisë Hua në dobi të NVM-ve të livruara nga BTP-ja dhe IF-ja	11,000,000		4,427,134		6,572,816
2. Fondi i Garancisë Mbulim i pjesshëm i rrezikut që lidhet me huat në dobi të NVM-ve	2,500,000		-		2,500,000
3. Asistenca Teknike	1,500,000		576,280		923,720
	Total	Vjetor	2017	2018	
3.1 Asistencë për NVM-të	600,000	200,000/vit	20,000	41,015	538,985
3.2 Asistencë për shoqatat e kategorisë	90,000	30,000/vit	10,232	18,717	60,910
3.3 Asistencë për METE-n dhe AIDA-n	90,000	30,000/vit	10,461	13,100	43,289
3.4 Veprimtari për administrimin e Programit	360,000	120,000/vit	107,237	102,541	80,964
3.5 Veprimtari mbështetëse	360,000	120,000/vit	69,392	61,700	199,590
Shuma e përgjithshme	15,000,000		5,003,414		9,996,586

Burimi: Të dhëna nga Njësia e Menaxhimit të Programit.

Në mënyrë të përmblëdhur referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultuan gjetjet si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Marrëveshja e financimit paraqet nevoja për zgjerimin/ndryshimi e fushës së aktivitetit dhe apo objektivave me qëllim rritjen e efektivitetit të Programit.
Situata:	Në lidhje me objektivat u konstatua se shuma e përgjithshme parashikon një kuotë financimesh të përshpejtuara në dobi të “projekteve të vogla” prej 3.5 milionë eurosh”. Në periudhën objekt auditimi është përdorur për financim 40.2 % e shumës totale të kredisë prej 11,000,000 Euro, janë financuar 10 projekte të vogla me vlerë totale 282,304 Euro, ose 8.06% e shumës 3,500,000 Euro të parashikuara për projektet e vogla. Nga programi janë financuar 11 mikrondërmarrje, 9 ndërmarrje të vogla dhe 5 ndërmarrje të mesme. Vlera e financimit të projekteve të vogla është shumë e ulët dhe vlerën me të madhe të financimit për periudhën objekt auditimi e kanë përfutur vetëm 4 subjekte me vlerë 1,927,600 Euro ose 44% . Kjo tregon se objektivi për përdorimin e shumës 3.5 milionë Euro nga kredia për financimin e projekteve të vogla të parashikuara në marrëveshje, në goftë se do të vazhdohet sipas këtij trendi,

	nuk do të jetë i realizueshëm.
Kriteri:	Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 3, neni 5 dhe neni 14 si dhe Manuali Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 3, Kapitulli 4 dhe Kapitulli 7.
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitete eficientë dhe ekonomikitet i fondeve të Programit.
Shkaku	Mungesa e vlerësimit të saktë të efektivitetit të programit nga CLSC/PMU sipas ndryshimeve të tregut të kredive.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	CLSC/PMU në bashkëpunim me ekspertin e huaj të evidentojnë problematikat dhe pengesat e dala nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të thelluar si dhe të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e rishikimit të marrëveshjes për shmangien e pengesave që financimi të jetë efektiv e i qëndrueshëm në zhvillimin e NVM-ve me qëllim krijimin e kushteve që kredia e ofruar nga BTP nëpërmjet programit të jetë një produkt konkurrues në treg. Gjithashtu, CLSC/PMU dhe BTP të rishikojnë marrëveshjen “On Lending Agreement”, për krijimin e kushteve të tilla që pjesëmarrja e NVM-ve në program të jetë më e lartë (thjeshtimin e dokumentacionit të kërkuar kur risku mbahet 100 % nga BTP-të) dhe ky rishikim të kryhet në përputhje me ndryshimet që mund ti bëhen marrëveshjes financiare midis huadhënësit dhe huamarrësit.
Titulli i gjetjes:	Mos realizim i objektivave sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje.
Situata:	Në lidhje me objektivat u konstatua se: - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e numrit të huave me afat të mesëm/të gjatë në dobi të përfutësve parësore nga ana e BTP pjesëmarrëse, krahasuar me programin PRODAPS. Gjatë programit PRODAPS janë realizuar 114 financime me një mesatare 14 financime në vit, kurse për programin IASME janë realizuar 25 financime me një mesatare 8 financime në vit. Si rrjedhojë kemi një rënie të financimeve. Gjithashtu 44 % e vlerës së financimit për periudhën objekt auditimi e kanë përfituar 4 subjekte, fakt ky i cili nuk reflekton rritje të numrit të kredi marrësve në dobi të NVM^{ve}; - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e punësimit të grave dhe të rinjve mes NVM^{ve} përfituese sepse nga programi i financimit PRODAPS janë krijuar mesatarisht 11 vende të reja pune për çdo financim, kurse nga programi i financimit IASME janë krijuar mesatarisht 6 vende të reja pune, nga financimet e monitoruara, pra krijimi i vendeve të reja të punës është në rënie krahasuar me programin PRODAPS. Gjithashtu nga ana e PMU/CLSC nuk ka një monitorim se sa gra dhe të rinj janë punësuar në këto vende pune të krijuara prej subjekteve të financuara nga programi; - <u>Nuk është realizuar</u> rritja e NVM^{ve} shqiptare që përfitojnë certifikime të cilësisë (ISO 9001) dhe mjedisore (ISO 14001) pasi Njësia e Menaxhimit të Programit dhe Komiteti Drejtues i Kredive (PMU/CLSC) nuk kanë monitoruar sa subjekte të financuara nga programi janë pajisur me këto certifikata dhe nuk është dhënë asnjë ndihmë, asistencë teknike dhe

	konsulencë, për pajisjen e tyre me këto certifikata; - Është realizuar pjesërisht rritja e huave nga ana e instituteve financiare pjesëmarrëse në dobi të NVM^{ve} që ndodhen jashtë korridorit Tiranë-Durrës. Për periudhën objekt auditimi, jashtë kësaj zone janë financuar 19 subjekte ose 76 % e totalit, ose 60 % e vlerës së financuar dhe 6 subjekte në zonën Tiranë-Durrës të cilat zënë një vlerë të konsiderueshme (40 % të vlerës së financuar). Gjithashtu nuk kemi një përfshirje të të gjitha zonave më pak të zhvilluar të vendit dhe për qarqet Vlorë, Kukës dhe Dibër nuk rezulton asnjë financim; -Nuk është kryer nga ana e PMU/CLSC monitorim dhe vlerësim gjatë implementimit të programit si dhe mbledhje e të dhënave në mënyrë sistematike duke i renditur ato sipas një skeme të mirë përcaktuar të cilat janë shtylla kryesore për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e treguesve të matshëm. - <u>Nuk është analizuar</u> raporti midis numrit të kredive mbi totalin e kredive të dhëna nga BTP dhe rritja në vlerën e shtuar të prodhimeve të përfituesve.
Kriteri:	Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 3, neni 5 dhe neni 14 si dhe Manuali Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 3, Kapitulli 4 dhe Kapitulli 7.
Ndikimi:	Mos përmbushje e pjesshme e objektivave të parashikuara në marrëveshje
Shkaku	Mungesa e përmbushjes së detyrave funksionale të CLSC/PMU në lidhje me monitorimin e realizimit të objektivave.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masa për organizimin e fushatave promovionale për të informuar bizneset në zonat e pa zhvilluara (kjo sipas parashikimeve të bëra në pikën 5.4.5 Aktivitetet Mbështetëse të Programit, germa c Promovimi i Komponentëve të Programit), të cilat nuk kanë akses në BTP për marrje kredie, për produktet financiare që ofron programi i financimit si dhe reklamimi i materialeve promovionale në qendrat dhe institucionet që kanë kontakte të drejtpërdrejta me publikun me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të Programit.
1.2 Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masat e nevojshme për një monitorim dhe vlerësim të thelluar të të dy programeve, PRODAPS dhe IASME duke bërë të mundur evidentimin e pengesave të lindura, në të gjitha hallkat e procesit të kredi dhënies nga BTP, përgjatë implementimit të projektit që kanë ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të parashikuara në marrëveshje.
1.3 Rekomandimi:	CLSC/PMU në bashkëpunim me ekspertin e huaj të përcaktojnë tregues të matshëm dhe të verifikueshëm që do të bëjnë të mundur evidentimin e problematikave në realizimin e objektivave të programit në kohë reale gjatë implementimit të tij.
Për mosrealizimin ose realizimin e pjesshëm të objektivave ngarkohet me përgjegjësi Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë (CLSC) i përbërë nga z. N. L. përfaqësues të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, z. E. M. ish – anëtar Bordi deri në 17.09.2019, z. D. D., përfaqësues i Bankës së Shqipërisë, z. S. S. Ambasada Italiane-Atashe Tregtar dhe z. N. M. Drejtor i Kooperacionit Italian për Bashkëpunim dhe Zhvillim CLSC si dhe z. G. L. Drejtori i PMU – së për projektin.	
Titulli i gjetjes:	Mos realizimi i objektivave dhe parashikimeve sipas komponentëve të

	marrëveshjes.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se: - Komponentët përbërës të kredisë nuk janë disbursuar brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje. Gjithashtu nga komponenti “Asistencë Teknike” nuk janë realizuar të gjitha parashikimet të cilat do të ndihmonin në realizimin e objektivave në tërësi të programit. - Fondi qarkullues, i krijuar nga rimbursimi i huas nga BTP, deri në datën 30.04.2020 është, nga programi PRODAPS 23,372,870.47 Euro dhe nga programi IASME 539,036.31 Euro. Nga ky fond me të njëjtin mekanizëm do të financohen projekte për NVM ndërmjet BTP bazuar në marrëveshjen “On Lending Agreement” në fuqi. Kostot e veprimtarisë, për elementët përbërës të “Asistencës Teknike”, të parashikuara në marrëveshjen e programit IASME janë për një periudhë tre vjeçare sipas afatit të disbursimit e përlllogaritur mesatarisht 500,000 Euro/vit. Për sa i përket kohëzgjatjes së PRODAPS është 38 vjet, referuar nenit 4 të ligjit 9527 datë 11.05.2006 dhe për IASME është 16 vjet, referuar nenit 6 të ligjit 19/2014 datë 27.02.2014. Vihet re se të dy programet <u>kanë një shtrirje në kohë që tejkalon planet e detajuara për menaxhimin e programit të parashikuara në marrëveshjet e financimit, e cila ka parashikuar të jetë 3 vjet.</u> Nga ana e organeve drejtuese e menaxhuese të programit, MFE, CLSC, PMU dhe Njësive Lokale të huadhënësit <u>nuk janë përgatitur plane financimi që do të mundësojnë menaxhimin e programit përgjatë kohëzgjatjes së parashikuar.</u>
Kriteri:	Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 9, neni 10, neni 11 dhe neni 12, Shtojca 1 ‘Dokumenti i programit, përmbledhje dhe kuadri logjik’ pika 4 si dhe Manualin Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 5, pika 4.
Ndikimi:	Mos përmbushje e pjesshme e komponentëve të parashikuara në marrëveshje.
Shkaku	Mungesa e përmbushjes së detyrave funksionale të CLSC/PMU në lidhje me monitorimin e realizimit të objektivave dhe komponentëve të programit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e një vendosjeje sa më të drejtë dhe të arritshëm të komponentëve të programit duke ju përshtatur nevojave të projektit përgjatë kohëzgjatjes të cilësuar në marrëveshje.
1.2 Rekomandimi:	CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e programimit të fondeve për mbulimin e veprimtarisë për administrimin e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes së parashikuar të tij, kjo për të shmangur mosfunksionimin e veprimtarisë së PMU si zbatuese e projektit përpara përfundimit të afateve në përputhje me parashikimet e cilësuar në marrëveshje.

Për mosrealizimin ose realizimin e pjesshëm të komponentëve të veprimtarisë së programit ngarkohet me përgjegjësi Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë (CLSC) i përbërë nga z. N. L. përfaqësues të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, z. E. M. ish – anëtar Bordi deri në 17.09.2019, z. D. D., përfaqësues i Bankës së Shqipërisë, z. S. S. Ambasada Italiane-Atashe Tregtar dhe z. N. M. Drejtor i Kooperacionit Italian për Bashkëpunim dhe Zhvillim CLSC si dhe z. G. L. Drejtori i PMU – së për projektin.

Për këto çështje Z. G. L., Drejtor i PMU-së, ka dërguar observacionin e administruar në KLSH me shkresën nr. Prot 287/7 datë 27.08.2020, për të cilat janë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

PMU nuk ka asnjë akses në vendimmarrjen e bankave për financimin e projekteve të SME-ve, pasi Marrëveshja e Programit dhe Marrëveshja Financiare të lidhura mes dy qeverive, si dhe Marrëveshja e Huas me Bankat dhe jo bankat, e kanë lënë tërësisht në vendimmarrje të këtyre të fundit financimin ose jo të projekteve të SME-ve. Sqarojmë se, të gjitha SME-të që kërkojnë financim me linjë kredie janë të detyruara të paraqiten në bankë, dhe është banka e cila vendos nëse këto projekte do të financohen apo jo, duke zbatuar fillimisht rregullat e saj të brendshme dhe ato të përcaktuara nga Banka Qendrore. PMU kryen vetëm disbursimin e fondeve, sipas kërkesave të ardhura nga këto institucione financiare dhe verifikon vetëm përputhshmërinë me kushtet e Programit (numrin e punonjësve, qarkullimin vjetor, origjinën italiane të mallrave, kapitalin e shoqërisë për maxhorancë shqiptare). PMU nuk ka asnjë akses për të detyruar bankat që të financojnë projekte nga një sektor i caktuar, apo nga një rajon i caktuar, apo biznese të reja startup, apo biznese të drejtuara nga gratë apo të rinjtë, apo biznese që krijojnë vende të reja pune, sepse është banka që mbart 100% riskun e financimit dhe është banka që ka të drejtën themelore të kryejë analizën e riskut, analizën financiare, analizën e kolateralit/garancisë dhe për rrjedhojë është ajo vendimmarrëse.

PMU ka marrëveshje me Bankën C., R. Bankë, I. S. P., U. Bankë, T. Bankë, B. K. T., S. G. A.(O. Bankë), N. Bankë (A. Bankë). PMU ka për detyrë të negociojë me BTP në lidhje me bashkëpunimin e tyre me programin, të krijojë takime të vazhdueshme në lidhje me bankat e reja partnere për nënshkrimin e marrëveshjes mes PMU dhe BTP. Në Dhjetor 2017, janë bërë pjesë të PMU 3 institucione financiare (F. B., N., F. I.). Në muajin Korrik, Gusht 2018 janë bërë takime nga Drejtori i PMU Z. G. L. me çdo bankë partnere si ato që kanë nënshkruar marrëveshjen me PMU si dhe ato të cilat akoma nuk e kanë nënshkruar, për të sqaruar çdo paqartësi dhe për të marrë mendimet e tyre për ecurinë e këtij bashkëpunimi. Fluksi i kërkesave për kredi influencohet nga shumë faktorë të jashtëm ambiental, dhe është në bazë të ecurisë së kërkesës që ka tregu si dhe nga kërkesa specifike për teknologji dhe pajisje me certifikatë origjinë italiane. Monitorimet dhe takimet me bankat partnere bëhen të vazhdueshme çdo 4 muaj si dhe, sa herë që ato kanë problematika dhe kërkesa. Gjithashtu në muajin Qershor 2019 së bashku me Ministren e Financave dhe Ekonomisë Znj. A. D., Ambasadorin e Ambasadës Italiane në Shqipëri, CEO-t e bankave partnere dhe Drejtorin e Kooperacionit Italian, PMU zhvilloi një takim me të gjitha bankat partnere në lidhje me të gjitha kërkesat apo pritshmëritë që ato kanë në lidhje me programin, duke marrë parasysh ndryshimet që tregu ka pësuar me kalimin e kohës. Të 11 bankave partnere i është dërguar një pyetësor nga ana e PMU në lidhje me pritshmëritë, kërkesat apo sugjerimet që ato kanë hasur. Bashkëlidhur një përmbledhje e tyre e cila më pas është paraqitur dhe në mbledhjen e CLSC numër 39. Përmbledhja e përgjigjeve të bankave dhe minutat e mbledhjes 39 të CLSC ju dërguan zyrtarisht me observacionin mbi akt verifikimet e auditimit të KLSH.

PMU nga skema e asistencës teknike ka ndihmuar 13 kompani për pajisjen e tyre me certifikime ISO, në periudhën 2017-2018. Në Manualin Operacional nuk është vendosur si indikator sesa nga subjektet e financuara janë pajisur me certifikatë ISO, pasi nuk përbën kusht për t'u financuar nga Programi. Ky zë do të rekomandohet në mbledhjen e CLSC që të shtohet për monitorim.

-Përdorimin e shumës 3.5 milion euro nga kredia për financimin e projekteve të vogla, është thjesht një parashikim Ad Hoc i Manualit Operacional, dhe jo i Marrëveshjeve qeveritare, dhe nuk është aspak detyruese, pasi PMU nuk ka asnjë akses në përzgjedhjen e projekteve të SME-ve. PMU është një program ku fasha e financimit mbulon si startup, dhe bizneset e vogla dhe të mesme. PMU financon projekte të propozuara nga bankat pasi biznesi në fillim drejtohet në to. Kjo tregon se interes kanë patur projektet me vlerë më të madhe por kjo s'është thotë që PMU ka bërë selektim në to, thjesht trendi ka qenë i ndryshëm. PMU nuk është dezinjatore e tregut por i përgjigjet kërkesës ekzistuese. Në ekonominë e tregut kërkesa për kredi përcaktohet nga: Ambienti i përgjithshëm i biznesit, politikat makro dhe mikro, ambienti i konkurrencës dhe politikat specifike fiskale tatimore të inovacionit të edukimit etj në të cilat PMU nuk ka një rol kontrollues etj.

-PMU ka bërë monitorim të vazhdueshëm të indikatorëve të Programit, dhe ka mbledhur në mënyrë sistematike të dhënat, sipas një skeme të mirë përcaktuar në Manualin Operacional. Të gjithë indikatorët janë prezantuar në çdo mbledhje të CLSC. Indikatorët që PMU monitoron janë përcaktuar në Manualin Operacional, kapitulli 7 "Monitorimi", paragrafi d. dhe konkretisht:

- Raporti midis numrit të kredive të linjës së kreditit të aprovuar mbi totalin e huave të disbursuara nga bankat pjesëmarrëse
- Shpërndarja e përfituesve sipas zonave gjeografike
- Shpërndarja e përfituesve sipas sektorit / përparësive të përcaktuara në Marrëveshjen e Huadhënies
- Shkalla e punësimit / vendeve të reja të punës ose postet e krijuara
- Investime në terren të gjelbër / numri i ndërmarrjeve të reja që kanë përfituar nga facilitetet e Programit (përfshirë startup e emigrantëve)
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës / rritja e vlerës së shtuar të përfshirë në mallrat e prodhuara nga përfituesit
- Norma bazë e interesit - Shkalla e REPO
- Bonot e Thesarit norma mesatare 12 muaj
- Shkalla e 12 muajve EURIBOR
- Norma mesatare vjetore e interesit për kreditë e shprehur në Euro dhe lekë
- Norma mesatare vjetore e interesit për depozitat e shprehur në Euro dhe lekë
- Shkalla vjetore e parashikuar e inflacioni

Qëndrimet e audituesve shtetëror të KLSH-së:

Programi IASME është një vazhdim i programit PRODAPS dhe ka si qëllim përmirësimin e rezultateve të tij, kështu që grupi i auditimit për të analizuar arritjen e objektivave sipas indikatorëve të verifikueshëm i është referuar Manualit Operacional, kapitulli 7 "Monitorimi" si dhe tabelës 3.1 "Baza e kuadrit logjik të ndërhyrjes" Shtojca 1, të Ligjit nr. 19/2014 datë 27.02.2014, "Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare" këto të krahasuara me programin PRODAPS. Një pjesë e këtyre indikatorëve janë subjektiv dhe të pa matshëm.

Indikatorët e matshëm e të verifikueshëm tregojnë realizimin e objektivave të programit dhe krahasimi i tyre midis programeve PRODAPS e IASME tregon se këta indikatorë nuk janë përmirësuar, pra objektivat e programit nuk janë realizuar. Për pretendimin tuaj “PMU nga skema e asistencës teknike ka ndihmuar 13 kompani për pajisjen e tyre me certifikime ISO, në periudhën 2017-2018”, nuk qëndron pasi në dispozicion të grupit të auditimit nuk është vendosur asnjë listë e këtyre kompanive ose ndonjë certifikatë ISO e përfituar prej tyre. Për pretendimin tuaj “Përdorimi i shumës 3.5 milion euro nga kredia për financimin e projekteve të vogla, është thjesht një parashikim Ad Hoc i Manualit Operacional, dhe jo i Marrëveshjeve qeveritare, dhe nuk është aspak detyruese, pasi PMU nuk ka asnjë akses në përzgjedhjen e projekteve të SME-ve “ nuk qëndron pasi kjo është e parashikuar në Marrëveshje, Shtojca 1, Dokumenti i Programit – Përmbledhje dhe Kuadri Logjik, 3.1 “Baza e kuadrit logjik të ndërhyrjes”. Krahas indikatorëve të përcaktuar në Manualin Operacional, kapitulli 7 “Monitorimi” PMU duhet të përfshinte dhe ato të përcaktuara në kuadrin logjik të marrëveshjes. Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nuk sjell argumente dhe fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Titulli i gjetjes:	Domosdoshmëria e zgjatjes së kontratave të punës së stafit të PMU.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi 01.06.2017 deri më datën 30.04.2020 rezulton se kontratat e punonjësve të PMU, për një periudhë prej të paktën 1 vit e gjysmë janë me afat 3 muaj në mënyrë të përsëritur. Punonjësit aktual kanë eksperiencë pune brenda këtij projekti dhe brenda të njëjtës PMU deri në 11 vite. Në fakt, duke qenë se programet PRODAPS dhe IASME janë parashikuar të jenë aktive deri në 38 vite (nisur nga viti 2008) dhe 16 vite (nga viti 2018), pra të paktën edhe 14 vite, në gjykim të grupit të auditimit një veprim i tillë jo vetëm që nuk i shërben objektivave të programit por gjithashtu nuk krijon mundësinë e një strukture të qëndrueshme dhe me staf gjithnjë e më të kualifikuar dhe të motivuar me qëllim përmbushjen e objektivave të vetë programit.
Kriteri:	Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 5, paragrafi i parë si dhe neni 7.
Ndikimi:	I mesëm.
Shkaku	Mosveprim i CLSC/PMU.
Rëndësia:	E mesme.
1.1 Rekomandimi:	CLSC të marrin masa për shmangien e kontratave afatshkurtra të punës për stafin e PMU-së të cilat për të mundësuar një strukturë të qëndrueshme dhe motivuese për stafin dhe përmbushjen e objektivave të programit.

2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Sipas Marrëveshjes së Programit të financimit, kredia e butë është në shumën 15,000,000 Euro e cila ndahet në, një shumë prej 11,000,000 Euro për financimin e projekteve të SME-ve, në shumën prej 2,500,000 Euro për financimin e fondit të garancisë ndaj subjekteve për tu

zvogëluar atyre vlerën e kolateralit të lënë si garanci dhe shuma prej 1,500,000 Euro e cila do të shërbejë për financimin e asistencës teknike. Në marrëveshje përcaktohet se kredia do të alokohet në dy transhe në formë paradhënie: Kërkesa për disbursimin e transhit të I-rë është në shumën 5,500,000 Euro, e cila është kredituar pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare, dhe është bërë aktive në bankën I. S. P. me datë 30.04.2016, duke qenë se janë krijuar organet e menaxhimit të Programit dhe është përzgjedhur shoqëria e Auditimit. Kërkesa për disbursimin e transhit të II-të do të alokohet në momentin që është kredituar të paktën 80% e disbursimit të parë dhe pas aprovimit e verifikimit nga MAE-DGCS (Ministria e punëve të jashtme të Italisë/Drejtoria e përgjithshme e bashkëpunimit për zhvillim).

Komiteti drejtues i linjës së kredisë (CLSC) është organi që harton politikat lidhur me Menaxhimin financiar të programit për mbajtjen e kontabilitetit, raportimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e programit dhe (PMU) është Njësia e Menaxhimit të Projektit e cila përbëhet nga z. G. L. në cilësinë e drejtuesit, znj. B. J. në cilësinë e financieres së programit, znj. E. M. asistente programi, znj. L. H. menaxhere komunikimi dhe informimi dhe znj. P. K. asistente administrative dhe specialiste prokurimesh. Në këtë fazë të auditimit rezulton se është disbursuar mbi 80% e shumës së parë të alokuar, pra shuma prej 4,427,134 Euro.

Afatet dhe kushte e kredisë të përcaktuara në marrëveshjen financiare janë:

Kohëzgjatja e këtij projekti është përcaktuar të jetë 16vjet;

Periudha e shlyerjes është përcaktuar të jetë 8 vjet;

Norma e interesit është përcaktuar të jetë 0,0%, pra pa interes për kthimin e financimit. Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë është organi që harton politikat lidhur me Menaxhimin Financiar të Programit për mbajtjen e kontabilitetit, raportimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e programit. Këto politika dhe procedura janë specifikuar në Manualin Operacional të PMU-së, të cilat janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të Marrëveshjes Financiare. Referuar Marrëveshjes së Programit në të cilën është parashikuar që shuma prej 11,000,000 Euro të disbursohet brenda një afati 3 vjeçar, të përcaktuar edhe në ligjin nr. 147/2013, datë 05.06.2013, si edhe në manualin operacional. Deri në 30.04.2020 rezulton të jetë disbursuar rreth 40% e shumës totale të financimit edhe pse ka kaluar mbi 3 vjet nga koha e alokimit të fondeve. Planifikimi i interesave bëhet nëpërmjet skeduleve të pagesave Program-Bankë ku, bankat paguajnë çdo 3muaj këstet e kredisë, sikurse është përcaktuar në marrëveshjen e Huas me bankat OLA. Interesat dhe principalet janë arkëtuar 100% sipas planifikimit. PMU nuk mund të bëjë një planifikim për penalitetet e vendosura ndaj të tretëve, ndërkohë që penalitetet e vendosura ndaj bankave janë arkëtuar në nivelin 100% të tyre. Për vitin 2017 është miratuar planifikimi vjetor i buxhetit në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë nr. 29, datë 01.03.2017, sipas shkresës përkatëse. Për vitin 2018 është miratuar planifikimi vjetor i buxhetit në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë me nr. 31, datë 23.11.2017, sipas shkresës përkatëse. Për vitin 2018 është miratuar planifikimi vjetor i buxhetit në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë me nr. 37, datë 05.02.2019, sipas shkresës përkatëse.

Për vitin 2020 nga PMU pretendohet se është miratuar planifikimi vjetor i buxhetit në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë me nr. 39, datë 05.12.2019, por për këtë planifikim nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion mbi vendimmarrjen nga CLSC.

Në programet e hartuara për secilin vit rezulton se nuk janë të detajuara sipas periudhave 3-mujore në mospërputhje me pikën 6.2 të Manualit Operacional. Gjithashtu nuk rezulton të jetë miratuar programi vjetor për vitin 2020, në mospërputhje me MO.

PMU ka bërë një planifikim mbi detajimin e shpenzimeve të asistencës teknike për shpenzime mbi pagat e sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzimet operative, shpenzime për procedurat

e prokurimeve, shpenzime për mbulimin e aktiviteteve për promovimin e programit, shpenzime për mbulimin e udhëtimeve, akomodimin e dietave, për realizimin e programit dhe mbulimin e kostove operacionale të tij, sipas çdo viti financiar.

Sistemi dhe menaxhimi i kontabilitetit është organizuar dhe mbahet sipas Manualit Operacional, mbi parimin CASH BASIS, në monedhat Euro dhe Lek. Kontabiliteti mbahet në software ELELCO, sipas llogarive të përcaktuara për çdo transaksion financiar.

Raportimi në Ministrinë e Financave bëhet sipas formatit të miratuar nga Ministri me urdhër nr. 12812, datë 15.12.2008 dhe raportohet në mënyrë periodike në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Huat që do të rimbursohen nga BTP dhe në bazë të rimbursimit do të formohet një fond rotativ, i cili do të drejtohet drejtpërdrejt nga METE. Fondi rotativ do të përdoret me të njëjtin mekanizëm për të financuar SME-të. Ky fond mbahet në llogari të veçantë të krijuar në një bankë të nivelit të dytë. Realizimi i disbursimit të Linjës së Kredisë sipas viteve është si më poshtë:

- Për periudhën 01.06.2017-31.12.2017 janë financuar 5 projekte të SME-ve shqiptare me një vlerë 571,930 €;
- Për vitin 2018 janë financuar 7 projekte të SME-ve shqiptare me një vlerë 1,431,670 €;
- Për vitin 2019 janë financuar 7 projekte të SME-ve shqiptare me një vlerë 1,167,640 €;
- Për periudhën deri në muajin prill 2020 janë financuar 6 projekte të SME-ve shqiptare me një vlerë 1,252,534 milionë Euro

Pra prej disbursimit të parë të projektit IASME rezulton se, nga Linja e Kredisë së programit janë financuar 25 projekte të SME-ve në shumën totale 4,427,134 euro, si dhe janë mbështetur me garanci 6 projekte në shumën prej 751,600 Euro, dhe vlera e financuar nga fondi i garancisë së programit është në shumën 420,700 euro.

Titulli i gjetjes:	Shpenzime jo efektive për realizimin e projektit.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera me anë të bankës për muajt tetor-dhjetor 2017, prill-qershor 2018 dhe qershor-shtator 2019, u konstatua se; me shkresën nr. 7416 prot., datë 12.10.2017 z. K. B. i drejtohet zyrës së O. L. & F. ShPK., për një argumentim ligjor mbi përgatitjen e përgjigjeve të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH, si dhe për interpretimin ligjor mbi aplikimin e penalitetit ndaj bankës për shlyerje të parakohshme të kredisë nga klienti “M. ShPK”, pra duhet të aplikohet penaliteti 4% apo penaliteti 0.5% ndaj bankës, në mbështetje të neneve të “On Lending Agreement”. Me shkresën nr. 1618 prot., datë 12.10.2017, administruar nga NJMP me nr. 7416/1prot., datë 13.12.2017 studio ligjore merr përsipër kryerjen e shërbimit kundrejt vlerës 1,500 Euro pa TVSh. Me shkresën nr. 1621prot., datë 16.10.2017, administruar nga NJMP me nr. 69prot., datë 23.10.2017, është dërguar shkresa për shërbimin e kryer nga studio, dhe fatura tatimore nr. 1332, datë 16.10.2017 në shumën 1,800 euro me TVSh. Me urdhër transfertën e datës 23.10.2017 është likuiduar fatura me nr. 1332, datë 16.10.2017 ndaj studios O. L. & F. me përfitues I. D. në shumën 1,800 euro. Ky shpenzim është kryer për përgatitjen e përgjigjeve të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe argumentimin ligjor të penalitetit për kthimin e shumës së kredisë përpara afatit nga subjekti “M. ShPK”. Shuma e likuiduar prej 1,800 euro është e pa argumentuar dhe e pa bazuar ligjërisht i cili është shpenzim i panevojshëm dhe përbën efekt negativ financiar për NJMP-në. Me aktin pa nr. Prot., datë

	04.08.2017, është hartuar dhe nënshkruar kontrata e shërbimit ndërmjet K. B. drejtor i NJMP dhe I. D. përfaqësues i studios ligjore O. L. & F. ShPK, me vlerë 2,500 Euro pa TVSh me objekt mundësimin e shërbimit për përgatitjen e opinionit ligjor të raportit të KLSH. Me urdhër transfertën e datës 05.09.2017 janë likuiduar fatura me nr. 1924, datë 23.08.2017 me shumë 1,200 Euro me TVSh dhe fatura me nr. 1301, datë 31.08.2017 me shumë 1,800 Euro, pra në total është likuiduar shuma prej 3,000 euro e cila është shpenzim i panevojshëm dhe përbën efekt negativ financiar për NJMP-në. Të dyja shpenzimet e mësipërme në janë veprime në mospërputhje me Manualin Operacional pasi, <i>nuk i shërbejnë qëllimit dhe objektit të linjës së kredisë</i> , pasi është detyrim i PMU dhe stafit për të përgatitur materialet e observacioneve të dërguara në KLSH dhe këto shpenzime nuk lidhen me objektin e veprimtarisë së programit, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi NjMP.
Kriteri:	Manuali Operacional.
Ndikimi:	Efekt financiar negativ në shumën 4,800 Euro.
Shkaku	Mos respektimin i parimeve të Manualit Operacional.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë, Drejtori i Njesisë së zbatimit të Projektit, të marrin masa që, për periudhën deri në përfundim të programit, shpenzimet për konsulencë ligjore dhe teknike të kryhen për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të programit, për përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.
Titulli i gjetjes:	Nuk janë hartuar plane pune periodike dhe nuk ka planifikim për nivelin e disbursimeve vjetore.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit mbi menaxhimin financiar, nivelin e realizimit të disbursimeve rezultoi se Linja e kredisë është alokuar në datë 30.04.2016 dhe është parashikuar që të financimi të shtrihej në një kohë brenda 3 viteve në shumën prej 11,000,000 euro. Për periudhën objekt auditimi pra deri në 30.04.2020, rezulton të jetë disbursuar rreth 40 % e shumës totale të financimit edhe pse ka kaluar mbi 3 vjet nga koha e alokimit të fondeve. Nga ana e drejtimit të projektit për periudhën objekt auditimit, konstatohet se nuk janë marrë masat e duhura për të kryer parashikime dhe plane pune 3-mujore të miratuara për asnjë vit, nuk ka planifikim për nivelin e disbursimeve, me qëllim nxitjen, promovimin dhe zhvillimin financimit të projekteve, për të gjitha aktivitetet e kërkuara në përmbushje të përfundimit të programit dhe mbulimin e kostove të tyre, i cili të jetë i aprovuar nga Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë.
Kriteri:	Manuali Operacional Kapitulli 6, pika 2.
Ndikimi:	Mos realizim i disbursimeve sipas parashikimeve të Linjës së Kredisë dhe mos kryerje e një planifikimi të detajuar vjetor, sidomos për nivelin e disbursimeve, nuk përmirëson transparencën e një menaxhimi të shëndoshë financiar dhe nuk siguron një përdorim efektiv të burimeve të programit me qëllim arritjen e objektivave të projektit. Gjithashtu CLSC si një strukturë operative, nuk ka marrë masat e duhura për të kryer një mbikëqyrje mbi efikasitetin dhe efikasitetin e Programit.
Shkaku	Mos planifikim periodik dhe nivel disbursimesh në programin vjetor të punës.

Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë, të marrin masa që, programet vjetore të punës të PMU, të përmbajnë dhe plane periodike 3-mujore për të bërë të mundur mbikëqyrjen/monitorimin dhe matjen e realizimit të objektivave, si dhe përdorimin sa më efektiv të burimeve të programit.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi PMU dhe CLSC.

2.5 Mbi zbatimin e procedurave dhe kushteve të linjës së kredisë.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr. 287/1prot, datë 11.03.2020, i ndryshuar, “Mbi zbatimin e procedurave dhe kushteve të linjës së kredisë”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Marrëveshja *On Lending Agreement*;
- 2- Dokumentacioni i dosjeve (shiko tabelën në Aneks 5.5, faqe 57 e Raportit Përfundimtar të Auditimit);
- 3- *Statement i llogarisë së Fondeve të PMU – së*;
- 4- *Manuali Operacional*;
- 5- *Etj.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultuan problemet si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Aplikimi nga Bankat e Ndërmjetme i komisioneve në dëm të Kredi marrësve në kundërshtim me marrëveshjen ‘ <i>On-Lending Agreement</i> ’.
Situata:	Në 22 raste janë aplikuar nga Bankat e Ndërmjetme komisione për kryerjen e shpenzime bankare, apo komisione për disbursimin e kredisë në përqindje të ndryshme të cilat variojnë nga 0.5 % deri në 10 %. Në fakt këto janë aplikuar në dëm të Klientëve në kundërshtim me marrëveshjen <i>On Lending Agreement</i> pasi këto komisione janë marrë përsipër nga Banka e Ndërmjetme e si të tilla janë detyrim i tyre dhe jo i kredimarrësve. Për rrjedhojë rezulton se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet shuma prej të paktën 31,070 € dhe 798,750 lekë të fondeve të Programit nga ana e Bankave sipas tabelës së përshkruar në Aneksin nr. 5.1, faqe 56 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Kriteri:	Marrëveshja “ <i>On – lending agreement</i> ”, artikulli 13 përcaktohet se: 13.1 “ <i>Banka e Ndërmjetme është e detyruar të paguajë, nëse ka, të gjitha taksat, detyrimet apo çdo obligim tjetër që ka të bëjë me këtë kontratë</i> ”; 13.2 “ <i>Banka e Ndërmjetme mbart të gjitha shpenzimet për shërbimet, shpenzimet bankare, transfertat dhe shpenzimet e konvertimit që mund të ndodhin bazuar në firmosjen dhe realizimin e kontratës në fjalë apo çdo dokumenti tjetër të lidhur me këtë kontratë</i> ”.
Ndikimi:	Përfitim i padrejtë i Bankës në dëm të Kredi marrësve dhe Linjës së Kredisë.
Shkaku	Interpretim i gabuar i marrëveshjes “ <i>On – lending agreement</i> ”.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masat e duhura për shmangien e aplikimeve të komisioneve të tilla në ngarkim të kredimarrësve siç janë ato të shumave prej 31,070 € dhe 798,750 lekë nga Bankat e përshkruara sipas tabelës në Aneks 5.1, faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim përdorimin e fondeve të Programit vetëm për përmbushjen e objektivave të parashikuara në marrëveshje.

Për sa më sipër subjekti i audituar, me shkresën nr. 4816/16 prot., datë 26.08.2020, administruar në KLSH me nr. 287/7, prot., datë 27.08.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

“Duke qenë se ndërmjet Programit dhe Bankave kryhen një sërë transaksionesh financiare gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës Program – Bankë, sikurse disbursimi i kredive, riparimet nga ana e Bankave të kësteve të kredive çdo tremujor, të gjitha kostot e konvertimit si rezultat i disbursimit të fondeve në Lek tek subjektet dhe kthimit të tyre në monedhën Euro, në formën e kësteve tre mujore në PMU etj., dhe të gjitha këto janë subjekt i komisioneve bankare, neni 13.1 dhe neni 13.2 ka për qëllim të sqarojë që këto komisione bankare do të paguhen nga ana e Bankave. Gjithashtu, në nenin 4.1 të OLA thuhet se: ‘banka do të përdorë rregullat e saj të brendshme të procedurave për ti dhënë hua përdoruesit përfundimtar. Pra nenet 13.1 dhe 13.2 lidhen ekskluzivisht me kontratën e lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankave Private, dhe jo me kontratën e lidhur mes bankave dhe përdoruesit final ndërsa dokumentet e tjera të lidhura me këtë kontratë janë 4 Aneksat e OLA janë 1. “përputhshmërisë së projektit”, 2. “projektet prioritare”, 3. “aplikimi i SME ve në bankë”, dhe 4. “kërkesa për disbursim”. PMU nuk ka asnjë autoritet apo detyrim ligjor që të ndërhyjë në marrëdhëniet kontraktuale, tregtare të subjekteve private siç është banka dhe ndërmarrjet. Marrëdhënia juridike midis MFE dhe Bankave është marrëdhënie tjetër, nga marrëdhënia juridike mes bankave dhe ndërmarrjeve private”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{së}:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren të pasqyruara në Aktin e Konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes:	Mos aplikim i penaliteteve ndaj Bankave të Ndërmjetme.
Situata:	Në 5 raste ndaj Bankave të Ndërmjetme nuk janë aplikuar penaltetet në shumën 38,520 € për mangësitë e konstatuara përgjatë dosjeve të kredive të dhëna ndaj subjekteve kredimarrëse sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Kriteri:	Marrëveshja “On – lending agreement”, artikulli 4.7 përcaktohet se: “Banka e Ndërmjetme është e detyruar ti paraqesë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, PMU – së, 180 ditë nga data e disbursimit të kredisë nga Ministria tek Banka e Ndërmjetme, dokumentacionin përkatës lidhur me realizimin e projektit dhe përdorimin e fondeve për çështjet e trajtuara në këtë kontratë” si dhe Artikulli 3.1, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4.
Ndikimi:	Dëm ekonomik në të ardhurat e Programit.
Shkaku	Mos aplikimi i penaliteteve sipas Marrëveshjes “On – lending agreement”
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masat e duhura për arkëtimin e shumës prej 38,520 € nga Bankat sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit nëpërmjet aplikimit të penaliteteve ndaj Bankave të Ndërmjetme.
Titulli i gjetjes:	Nuk janë marrë masa për kthimin pas të shumave të mbetura.
Situata:	Në 5 raste nuk janë marrë masa për evidentimin e mangësive dhe më pas kthimin pas të shumës së mbetur nga kreditë e dhëna në shumën totale prej 1,234,000 € për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion sipas

	tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se: 6. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme F. B. tek Klienti B. A. I. (shuma për kthim në masën 500,000 €)</u> - Nuk konfirmohet origjina italiane për 7 furnitorë të Klientit; - Për 5 furnitorë (nga këta 7 si më sipër) nuk konfirmohen dokumentet e zhdoganimit të materialeve; 7. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme C. tek Klienti I. N. F. (shuma për kthim 500,000 €)</u> Nga të gjitha shpenzimet justifikuese rezulton se me shkresën e administruar në PMU me nr. 36 prot., datë 05.05.2020 janë dorëzuar: - Faturat tatimore; - Deklaratat për zhdoganimin e makinerive dhe pajisjeve; - Swift pagesat në shumën 200,000 €; - Swift pagesat në shumën 300,000 €; Materialet e mësipërme rezulton se janë sjellë përtej afati 18 muaj nga data e disbursimit të kredisë. 8. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. G. (shuma për kthim 50,000 €)</u> - Deri në fund të afatit të parashikuar në marrëveshjen “<i>On lending Agreement</i>” nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit justifikues të pagesës së kryer në favor të Klientit. 9. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme T. B. tek Klienti E. (shuma për kthim 164,000 €)</u> - I gjithë investimi i kryer, referuar faturave dhe deklaratave doganore për blerjen e makinerive në shumën 135,520 Euro, e ka me origjinë Zvicerane dhe jo me origjinë Italiane, dhe blerja e makinerive dhe pjesëve është bërë në Zvicër dhe jo sipas parashikimeve të bëra në marrëveshjen “<i>On lending Agreement</i>”; 10. <u>Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. D. (shuma për kthim 70,000 €)</u> - Një prej faturave tatimore në shumën 66,790 € përmban shpenzime në shumën 16,667 € për blerje të kryera përpara datës së disbursimit të kredisë dhe si e tillë nuk duhet të merret në konsideratë si justifikim për fondet e Programit; - Një prej faturave tatimore me vlerë 999,810 lekë ose 7,680 € është përdorur për mbulimin e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit; - Një prej faturave tatimore me vlerë 960,000 lekë është përdorur për mbulimin e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit;
Kriteri:	Marrëveshja “ <i>On – lending agreement</i> ”, artikulli 7.5 përcaktohet se: “ <i>Në rast të konstatimit të shkeljes nga ndonjë prej kriterëve të pranueshmërisë, Banka e Ndërmjetme duhet rimbursojë të gjithë shumën e kredisë për MFE</i> ”.
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të programit në shumën 1,284,000 € si rrjedhojë e mos ripërdorimit të këtyre fondeve për kredi

	marrës të tjerë.
Shkaku	Mungesa e veprimeve të ndërmarra nga CLSC/PMU.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrë masa për respektimin e kriterëve të vendosura në lidhje me praktikën e dhënies së kredive dhe kthimin pas të shumave të tyre në rastet e shkeljes së kushteve të Marrëveshjes On Landing Agreement me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e Programit siç është rasti i mësipërm për 5 subjektet në shumën 1,234,000 € sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 57 e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër subjekti i audituar, me shkresën nr. 4816/16 prot., datë 26.08.2020, administruar në KLSH me nr. 287/7, prot., datë 27.08.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

“B. A. I. financuar nga F. B. ’

Në referencë të marrëveshjes On Lending Agreement, neni 4.7, thuhet se: “ Për raste specifike të përcaktuara në kontratën midis Përdoruesit Final dhe Furnizuesit, dhe dorëzuar në PMU, afati i paraqitjes së dokumenteve të lartpërmendur mund të jetë më i gjatë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, por jo më gjatë se 18 muaj nga data e lëvrimit të kredisë; Konkretisht, ky është një rast specifik, ku subjekti ka lidhur kontratë me furnitorin për arsye se investimi ishte ende në proces, kredia është lëvruar në datë 01.06.2018 dhe dokumentacioni final justifikues është dërguar në datën 05.07.2019, pra brenda 18 muajve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren të pasqyruara në Aktin e Konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit. Sqarojmë dhe një herë se nga ana e Audituesve Shtetërorë të KLSH nuk është përmendura fakti se nuk është marrë miratim dhe se nuk është brenda afatit 180 ditor, por është cituar se kërkesa për shtyrjen e afatit është bërë në një moment kur Banka e Ndërmjetme duhet të kishte marrë masa për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të Kredi marrësit. Shtyrja e afatit të dorëzimit të dokumentacionit **mund të kryhet pasi PMU t’i jenë dorëzuar dokumentet**. Kërkesa nga ana e Bankës së Ndërmjetme dhe miratimi nga ana Juaj është kryer në një moment kur dokumentacioni (sipas Kontratës në fuqi) duhet të ishte dorëzuar. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Pretendimet e subjektit të audituar:

“B. A. I. ” i ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 4.7 të Marrëveshjes së Huas, e cila është pjesë integrale e Manualit Operacional si Aneks nr 2 i saj. Citojmë nenin 4.7 të Marrëveshjes On Lending “.....Ky dokumentacion, në përputhje me nenin 3.4 të kësaj Marrëveshjeje do të përfshijë gjithashtu:

- pagesën swift/ certifikatën e pagesave për furnitorët,
- faturat pro forma,
- certifikata e zhdoganimit dhe
- faturat e TVSH-së për shpenzimet lokale.”

Pra, origjina italiane e mallrave përcaktohet nga certifikata e zhdoganimit. Për furnitorët e cituar nga ju janë dërguar në PMU certifikatat e zhdoganimit (CZH), të cilat ishin pjesë e dosjes së audituar nga KLSH:

Konkretisht:

Për M. srl

CZH nr. 23406 datë 21.03.2019, me shumë 20,000 Euro

CZH nr. 12004 datë 16.02.2019, me shumë 6,000 Euro

CZH nr. 11228 datë 13.02.2019, me shumë 54,000 Euro

Për C. srl

CZH nr. 3355 datë 18.01.2019, me shumë 8,665 Euro

Gjithashtu edhe për kostot lokale lidhur me pagesat e kryera ndaj furnitorëve shqiptarë “A. C. C.” sh.p.k., “A. M.”sh.a dhe “A. F. S. shpk”, të treja përfshihen në kosto lokale dhe që justifikohen me Faturat Tatimore me TVSH dhe transfertën. Në referencë të nenit 3.4, paragrafi 2 thuhet se: “një maksimum prej 30% (tridhjetë përqind) e fondeve të kredisë të siguruar nga MFE për një projekt janë përdorur nga Përdoruesi Final për të mbuluar kostot lokale ose nga vendet e tjera fqinje në zhvillim që lidhen me projektin. (shiko gjithashtu nenin 3.8.). Pra, në total mallrat me origjinë italiane janë në shumën 376,557 Euro ose 75.31% % të kredisë, ndërsa kostot lokale përbëjnë shumën 123,454.46 Euro ose % 24.69 % të kredisë. Gjithashtu edhe për kostot lokale lidhur me pagesat e kryera ndaj furnitorëve shqiptarë “A. C. C.” sh.p.k., “A. M.”sh.a dhe “A. F. S. ShPK”, të treja përfshihen në kosto lokale dhe që justifikohen me Faturat Tatimore me TVSH dhe transfertën. Në referencë të nenit 3.4, paragrafi 2 thuhet se: “një maksimum prej 30 % e fondeve të kredisë të siguruar nga MFE për një projekt janë përdorur nga Përdoruesi Final për të mbuluar kostot lokale ose nga vendet e tjera fqinje në zhvillim që lidhen me projektin. (shiko gjithashtu nenin 3.8.). Pra, në total mallrat me origjinë italiane janë në shumën 376,557 Euro ose 75.31% % të kredisë, ndërsa kostot lokale përbëjnë shumën 123,454.46 Euro ose % 24.69 % të kredisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren të pasqyruara në Aktin e Konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Pretendimet e subjektit të audituar:

‘I. N. F. financiar nga Banka C.’

Sqarojmë se afati 180 ditor i dorëzimit të dokumentacionit në PMU ka qenë 25.04.2020. Për arsye të situatës së jashtëzakonshme prej COVID 19 të nisur që në 11 Mars 2020, banka e ka dorëzuar dokumentacionin në 5.05.2020, por i gjithë dokumentacioni i dorëzuar si fatura, zhdoganime dhe pagesa është ekzekutuar brenda afatit 180 ditor.

Ndërsa, pagesa për shumën 65,000 Euro është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit.

‘A. G.’ Person Fizik financiar nga banka I. S. P.’

Lidhur me dërgimin nga banka të dokumentacionit justifikues të realizimit të projektit të investimit përtej afatit 18 mujor, sikurse përcaktuar në nenin 4.7 të OLA, PMU nuk ka kompetencë ligjore që të vendosë penaltete. Kjo është kompetencë e CLSC- Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë, sikurse parashikuar në Manualin Operacional nenin 4.1, pika n. Ky projekt do t’i paraqitet CLSC për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

‘E.’ ShPK financiar nga banka T.’

Ky projekt e ka sjellë dokumentacionin brenda afatit 180 ditor.

Gjithsesi, ky projekt i është dërguar CLSC—Komitetit Drejtues të Linjës së Kredisë për shqyrtim. CLSC e ka marrë projektin në shqyrtim në mbledhjen nr. 40 datë 13.02.2020, dhe pritet vendimmarrje në mbledhjen e radhës që do të mbahet në fund të muajit Korrik 2020.

‘A. D.’ financiar nga banka I. S. P.’

Dokumentacioni i këtij projekti është konsideruar i papranueshëm edhe nga PMU, dhe ky projekt do t'i paraqitet CLSC për shqyrtim në mbledhjen e radhës”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren të pasqyruara në Aktin e Konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes:	Pasaktësi në hartimin e Manualit Operacional.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren, materialeve dhe argumenteve të dhëna në observacionet për Akt Konstatimit, Projekt Raportin e Auditimit si dhe ato të dhëna në Takimin e Mirëkuptimit në KLSH, u konstatua se në Manualin Operacional të Programit ka mangësi në përcaktimin e dokumenteve justifikuese në lidhje me shpenzimet. Konkretisht, referuar Manualit Operacional, aneksit nr. 2 neni 4.7 dhe të Marrëveshjes On Lending thuhet se: <i>... gjithë dokumentacioni i paraqitur në PMU duhet të jetë fotokopje e certifikuar nga banka, dhe në nenin 4.7: “BANKA është e detyruar të paraqesë në MFE, në PMU, 180 ditë (njëqind e tetëdhjetë) nga data e disbursimit të kredisë nga MFE tek banka, dokumentacionin përkatës (fotokopje të certifikuara nga BANKA) në lidhje me realizimin e projektit dhe shfrytëzimi i fondeve për qëllimet e përcaktuara me këtë kontratë.</i> Njëkohësisht, në Kapitullin 6 Menaxhimi Financiar, pika 6.4 Sistemi i Kontrollit Financiar, nën pika 6.4.1 Kontrolli i Brendshëm, paragrafi i dytë ku përcaktohet se: <i>“Kontrollet e brendshme kryesore për tu aplikuar për programin përfshijnë: Dokumente origjinale të kompletuara duhet të ekzistojnë për të mbështetur transaksionet e programit”.</i> Nga sa më sipër rezulton se janë paraqitur si kriter për justifikimin e shpenzimeve të fondeve të Programit, dy mundësi të kundërta me njëra tjetrën, nga njëra anë fotokopje të certifikuara nga Banka e Ndërmjetme, kur në fakt Bankat nuk janë një organ i tillë certifikues e nga ana tjetër janë kërkuar që dokumentet justifikuese duhen origjinale.
Kriteri:	Manualin Operacional, Kapitulli 6 Menaxhimi Financiar, pika 6.4 Sistemi i Kontrollit Financiar, nën pika 6.4.1 Kontrolli i Brendshëm, paragrafi i dytë ku përcaktohet se: <i>“Kontrollet e brendshme kryesore për tu aplikuar për programin përfshijnë: Dokumente origjinale të kompletuara duhet të ekzistojnë për të mbështetur transaksionet e programit”</i> si dhe Manuali Operacional, aneksi nr. 2 neni 4.7.
Ndikimi:	Mungesa e gjurmëve të auditimit dhe paqartësi në dokumentacionin e kërkuar.
Shkaku	Interpretim i gabuar i marrëveshjes <i>“On – Lending Agreement”</i> .
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masa të azhurnojnë Manualin Operacional duke përfshirë në këtë material si kusht, përdorimin vetëm të materialeve origjinale në lidhje me argumentimin e shpenzimeve dhe të shmangin praktikat e certifikimit nga ana e Bankave të Ndërmjetme të materialeve fotokopje.

Për sa më sipër subjekti i audituar, me shkresën nr. 4816/16 prot., datë 26.08.2020, administruar në KLSH me nr. 287/7, prot., datë 27.08.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

“Në të gjitha dosjet e projekteve të kompanive të financuara, ku grupi i auditimit ka bërë interpretimin e mësipërm, në referencë të Manualit Operacional, aneksi nr. 2 nenit 4.7 dhe të Marrëveshjes On Lending nenit 4.7 thuhet se gjithë dokumentacioni i paraqitur në PMU duhet të jetë fotokopje e certifikuar nga banka, citojmë nenin 4.7:

“BANKA është e detyruar të paraqesë në MFE, në PMU, 180 ditë (njëqind e tetëdhjetë) nga data e disbursimit të kredisë nga MFE tek banka, dokumentacionin përkatës (fotokopje të certifikuara nga BANKA) në lidhje me realizimin e projektit dhe shfrytëzimi i fondeve për qëllimet e përcaktuara me këtë kontratë. Aneksi nr 4 “Kërkesa për financim” e cila përcakton drejtpërdrejt nenit të cilit ju i referoheni , është në çdo rast në origjinal, pasi është e firmosur nga banka”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin në lidhje me çështjen në fjalë duke kryer edhe korrigjimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve pas argumenteve të dhëna në observacion dhe në Takimin e Mirëkuptimit.

Titulli i gjetjes:	Financimi i Kredi marrësve të cilët nuk janë objekt i Marrëveshjes së Financimit.
Situata:	Në 11 raste janë financuar nga Programi shuma prej 1,114,134 € sipas listës së përshkruar në Aneks 5.4, faqe 56-57 e Raportit Përfundimtar të Auditimit për subjekte kredi marrës të cilësuar si <i>Mikrondërmarrje</i> , kur në fakt objekt financimi i këtij Programi kanë qenë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – të). Sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshjen e Financimit Mikrondërmarrjet, Ndërmarrjet e Vogla dhe ato të Mesme klasifikohen si të tilla në bazë të numrit të punëtorëve, përkatësisht, 1-9, 10-49 dhe 50 – 249. Në fakt rezulton se për këto 11 subjekte shuma e mësipërme prej 1,114,134 € është përdorur për të financuar projekte për ndërmarrje me 1-9 të punësuar. Konkretisht lista e këtyre subjekteve paraqitet sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.4, faqe 56 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Kriteri:	a. Ligji nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar me ligjin nr. 10042 datë 22.12.2008, në nenin 4 përcaktohet se: “1. Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme. 2. Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë. 3. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë. 4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë. 5. Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në: a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona; b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

	c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona." b. Ligji nr. 19/2014 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Realizimin e "Programit të Ndihmës së Integruar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Shqiptare": - Neni 1 <u>Përmbajtje dhe përkufizime të Marrëveshjes</u>, pika 1.3 <u>Fjalët dhe shkurtime të renditura më poshtë kanë kuptimet sikurse vijon</u>, paragrafi i katërbëdhjetë <u>ku përcaktohet se</u>: "NVM", shoqëri të së drejtës shqiptare, të quajtura ndërmarrje të vogla e të mesme nga ligji shqiptar për NMV-të; - Neni 3 Përshkrimi i Programit, paragrafi i tretë <u>ku përcaktohet se</u>: "Objektivi i veçantë i Programit është përmirësimi i marrëdhënies së besimit mes NVM-ve shqiptare dhe sistemit bankar vendas, duke nënkuptuar përfundimin e kredive si një mjet funksional në dobi të rritjes gjëresisht të sipërmarrjes, të krijimit të sipërmarrjeve të reja, si dhe në dobi të shpikjeve e risive në proceset e në prodhim, të mbështetjes ndaj vënies në jetë të praktikave që lidhen me përgjegjësitë shoqërore të sipërmarrjes, si dhe në dobi të bashkimeve funksionale mes NVM-ve; - Shtojca , paragrafi i katërt <u>ku përcaktohet se</u>: Përfutuese të nismës, në radhë të parë, janë sipërmarrjet e vogla e të mesme shqiptare, të nënkuptuara si entitete të veçanta prodhuese (sipas disiplinës legjislative shqiptare) apo në formë të grupuara (konsorciume, kooperativa, shoqata). Nisma parashikon, gjithashtu, asistencë për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për përcaktimin dhe projektimin e modeleve të zhvillimit për NVM-të shqiptare. c. Manualin Operacional, Kapitulli 4, pika 4.2.3 Lista e detyrave të PMU.
Ndikimi:	Mos përmbushje e objektivave të Programit dhe financimi me kredi i subjekteve që nuk janë objekt i Marrëveshjes së Financimit dhe përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në shumën 1,114,134 € .
Shkaku	Interpretim i gabuar i bazës ligjore në lidhje me Programin.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masa për financimin e Projekteve të Kredi marrësve që janë objekt i Marrëveshjes së Financimit, konkretisht Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe jo Mikrondërmarrjet me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve të Programit siç është ai i 11 Projekteve me shumë totale 1,114,134 € sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.4, faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër subjekti i audituar, me shkresën nr. 4816/16 prot., datë 26.08.2020, administruar në KLSH me nr. 287/7, prot., datë 27.08.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

"Në të gjitha dosjet e projekteve të subjekteve të financuara, ku grupi i auditimit ka bërë interpretimin e mësipërm, në Marrëveshjen e Huas "On Lending Agreement", që MFE lidh me Bankat Tregtare Private, në Nenin 3.2, janë përcaktuar kriteret e pranimi që duhet të përmbushi një NMV si më poshtë:

Shoqëria është e regjistruar në Shqipëri;

Jo më pak se 51 % e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga shtetas shqiptar;

Qarkullimi vjetor jo më i lartë se 10 milion Euro;

Numri i punonjësve jo më i lartë se 250 punonjës.

Kjo çështje është konsideruar e zgjidhur edhe nga grupi auditues i KLSH-së, në auditimin e ushtruar në PMU në vitin 2017”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren të pasqyruara në Aktin e Konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në dokumentacion.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të Kredi marrësve rezultoi se në të gjitha rastet, pra në 25 dosje të audituara, nuk rezultuan gjurmë të njoftimit nga banka e ndërmjetme drejtuar PMU, për kërkesën e subjekteve kredimarrëse. Gjithashtu, nuk është dërguar as dokumentacioni në formë fizike (hard copy) brenda afatit prej 5 ditësh.
Kriteri:	Manuali Operacional pika 5.2, “Linja e Kredisë” ku thuhet se: “PCB-të informojnë NjMP për secilën kërkesë për hua të marrë dhe transferojnë kopjet e të gjitha dokumenteve përkatëse të projektit brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas pranimit të secilës kërkesë.”
Ndikimi:	Mungesa e gjurmëve të auditimit.
Shkaku	Mungesa e kontrolleve nga ana e PMU.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	CLSC/PMU të marrin masa për plotësimin e 25 dosjeve të audituara me njoftimet e marra nga Bankat e Ndërmjetme për kërkesat për kredi.

2.6 Verifikimi dhe inspektimi në lidhje me eficiencën e kredive të marra nga SME – të në përputhje me Plan – bizneset e paraqitura prej tyre.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 287/1prot, datë 11.03.2020, i ndryshuar, u zhvilluan disa verifikime në ambientet e subjekteve përfitues të fondeve në Programin PRODAPS/IASME. Nga 26 subjekte në total (25 IASME + 1 PRODAPS), me vlerë totale të financuar në shumën 4,507,134 €, 7 prej tyre në vlerën 1,273,534 €, ose gati 28 % e totalit rezultuan në fazën e dorëzimit të dokumentacionit dhe për këto praktika nuk u kryen verifikime në terren. Nga 19 subjektet e tjera me shumë totale të financuar 3,233,600 €, u përzgjodhën për tu verifikuar në terren, kjo në bazë të vlerës më të lartë të financuar, 15 prej tyre ose gati 80 % në numër, me vlerë totale të shumës së financuar 2,909,600 €, pra gati 90 % në vlerë. Konkretisht u verifikuan subjektet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Dosja nr.	Banka	Kredi marrësi	Lloji i Kompanisë	Data e Disbursimit	Shuma (euro)	Interesi	Periudha e Pagesës	Periudha e Faljes
IASME									
1	115	U. B.	A. E. shpk	shpk	7-Aug-17	151,000.00	3	96	12 muaj
2	116	C.	O. H.	Person Fizik	8-Aug-17	195,500.00	4	96	3
3	117	U. B.	G. D.	Person Fizik	16-Oct-17	30,000.00	3	96	n/a
4	118	C.	E. T.	shpk	15-Dec-17	31,430.00	3	48	
5	119	T. B.	E. shpk	shpk	22-Dec-17	164,000.00	3	72	0
6	121	C.	T. K.	shpk	1-Jun-18	430,000.00	3	84	n/a
7	122	F. B.	B. A. I.	shpk	1-Jun-18	500,000.00	1	96	2
8	123	C.	F. B.	Person Fizik	3-Sep-18	167,300.00	4	96	0
9	124	I. S. P.	A.	shpk	19-Oct-18	200,000.00	3	84	12 muaj

10	126	F. I.	E. T. sh.p.k	sh.p.k	27-Dec-18	18,370.00	3	48	n/a
11	127	N.	G. J.	Person Fizik	8-Jan-19	47,000.00	3	60	n/a
12	128	C.	S. B.	Person Fizik	4-Mar-19	75,000.00	4	60	n/a
13	129	F. I.	E. T. sh.p.k/ 2. P.	sh.p.k	8-May-19	15,000.00	3	48	n/a
14	130	C.	R.	shpk	22-Jul-19	385,000.00	3	60	n/a
15	131	C.	I. N. F.	shpk	29-Oct-19	500,000.00	3	60	5 muaj

Nga verifikimi rezultoi se pajisjet e deklaruar nga klientët Kredimarrës përputhen me ato në fakt.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas korrespondencave rezulton se nuk janë marrë masa nga ana e CLSC/PMU në lidhje me programe të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve dhe njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda afatit 20 ditor. (*Shiko Aneks 1.1, faqe 51 – 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*). Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se KLSH për përmirësimin e situatës ka rekomanduar:

- 13 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 5 masa, 5 janë realizuar pjesërisht dhe 3 prej tyre nuk janë pranuar e zbatuar.

- 7 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 210,129 €, nga të cilat 4 janë zbatuar dhe 3 masa në shumën 165,629 € nuk janë pranuar e zbatuar.

- 2 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar të gjitha.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit” nenet 15 dhe 16. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 15-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin paraardhës dhe të përcaktojë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara dhe të marrë masat e duhura për zbatimin e plotë brenda afateve kohore të përcaktuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se pas bllokimit të fondeve të CDP (C. D. e P.) nga Gjykata e Romës të të gjitha fondeve dhe të gjitha disbursimet në llogaritë e hapura jashtë territorit italian, me datë 12.11.2018 i është dërguar një MEMO Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nga ana e NJMP ku është kërkuar shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve të akorduara për këtë projekt. Afati i fundit i disbursimeve ka qenë data 18.12.2018 dhe deri me datë 12.11.2018 kanë rezultuar ende 8 milion euro të pa disbursuara. Në datën 13.11.2018 Ministri i Financës dhe Ekonomisë i ka dërguar shkresën nr. 340 prot. mbi nevojën e kërkesës për shtyrjen e afatit të disbursimit të fondeve të programit IASME. Në datën 15.11.2018 Ministri i Financës dhe Ekonomisë i ka dërguar C. D. P. shkresën nr. 20467 prot, ku i ka kërkuar shtyrjen me 12 muaj të afatit të disbursimit të fondeve C. D. P. ka kthyer përgjigje me datë 26.11.2018 ku ka pranuar shtyrjen e afatit me 12 muaj të disbursimit të fondeve. Në datën 17.12.2019 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar shkresën nr. 21446 ‘Për mendim këshillor’ Avokaturës së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi Projekt-Vendimin “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , dhe A. S.P.A, për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare ratifikuar me ligjin nr. 147/2013”. Në këtë Projekt-Vendim kërkohet shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve deri me datë 31.12.2021 si edhe shtyrja e afatit të përdorimit të fondeve të dedikuara për asistencë teknike deri më 30.04.2022. Në datën 26.12.2019 dhe në datën 13.02.2020 Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë mbi ndryshimet që duhen të bëhen në këtë marrëveshje si edhe rrugën ligjore që duhet të ndiqet

për ta bërë këtë ndryshim duke i rekomanduar MFE që të veprohet konform ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Në datën 13.01.2020 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë mbi ndryshimet e propozuara që duhen të bëhen në këtë marrëveshje. Ministria e Financës dhe Ekonomisë pas përgjigjeve të marra nga këto institucione dhe ndryshimeve të propozuara ka riformuluar disa pika të Projekt-Vendimit. Megjithatë në datën 13.02.2020 Ministria e Drejtësisë ka shprehur dhe njëherë mosdakordësinë e saj për disa pika të Projekt-Vendimit. Pas ndryshimeve përfundimtare të pasqyruara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, ky Projekt – Vendim është miratuar në parim nga Kryeministri i Shqipërisë, por ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave çka bën që kjo shtyrje e afateve të disbursimit të fondeve dhe afatit të përdorimit të fondeve për asistencën teknike mos ti jetë paraqitur ende C. D. P.. Fakti që afati i përdorimit të fondeve për asistencë teknike ka përfunduar dhe shtyrja e tij ende nuk është zyrtarizuar ka bërë që shpenzimet e kryera për asistencën teknike janë paguar nga të ardhurat e përfituara prej penaliteteve nga Marrëveshja Financiare prej 27.5 milion euro e nënshkruar ndërmjet MF dhe A. S.P.A më datë 24.02.2006 dhe është ratifikuar në Parlament me ligjin nr. 9528, datë 11.05.2006. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Marrëveshjen e Financimit të Programit IASME e ratifikuar në parlament me ligjin nr. 147/2013, “*Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e NMV-ve Shqiptare*”, neni 9, pika 9.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e CLSC/PMU-së të vihet dhe njëherë në vëmendje të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rëndësia e ndryshimit të kësaj marrëveshje sa më shpejt për të mos rrezikuar mbylljen e këtij Programi Financimi i cili i ka ardhur në ndihmë ndërmarrjeve të vogla e të mesme shqiptare.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me objektivat u konstatua se shumica e përgjithshme parashikon një kuotë financimesh të përshpejtuara në dobi të “projekteve të vogla” prej 3.5 milionë eurosh”. Në periudhën objekt auditimi është përdorur për financim 40.2 % e shumës totale të kredisë prej 11,000,000 Euro, janë financuar 10 projekte të vogla me vlerë totale 282,304 Euro, ose 8.06% e shumës 3,500,000 Euro të parashikuara për projektet e vogla. Nga programi janë financuar 11 mikrondërmarrje, 9 ndërmarrje të vogla dhe 5 ndërmarrje të mesme. Vlera e financimit të projekteve të vogla është shumë e ulët dhe vlerën me të madhe të financimit për periudhën objekt auditimi e kanë përfituar vetëm 4 subjekte me vlerë 1,927,600 Euro ose 44% . Kjo tregon se objektivi për përdorimin e shumës 3.5 milionë Euro nga kredia për financimin e projekteve të vogla të parashikuara në marrëveshje, në qoftë se do të vazhdohet sipas këtij trendi, nuk do të jetë i realizueshëm.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 3, neni 5 dhe neni 14 si dhe Manuali Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 3, Kapitulli 4 dhe Kapitulli 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: CLSC/PMU në bashkëpunim me ekspertin e huaj të evidentojnë problematikat dhe pengesat e dala nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të thelluar si dhe të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane

(Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e rishikimit të marrëveshjes për shmangien e pengesave që financimi të jetë efektiv e i qëndrueshëm në zhvillimin e NVM-ve me qëllim krijimin e kushteve që kredia e ofruar nga BTP nëpërmjet programit të jetë një produkt konkurrues në treg. Gjithashtu, CLSC/PMU dhe BTP të rishikojnë marrëveshjen “On Lending Agreement”, për krijimin e kushteve të tilla që pjesëmarrja e NVM-ve në program të jetë më e lartë (thjeshtimin e dokumentacionit të kërkuar kur risku mbahet 100 % nga BTP-të) dhe ky rishikim të kryhet në përputhje me ndryshimet që mund ti bëhen marrëveshjes financiare midis huadhënësit dhe huamarrësit.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me objektivat Programit për periudhën objekt auditimi 01.06.2017 deri më datën 30.04.2020 u konstatua se:

- Nuk është realizuar rritja e numrit të huave me afat të mesëm/të gjatë në dobi të përfutuesve parësore nga ana e BTP pjesëmarrëse, krahasuar me programin PRODAPS. Gjatë programit PRODAPS janë realizuar 114 financime me një mesatare 14 financime në vit, kurse për programin IASME janë realizuar 25 financime me një mesatare 8 financime në vit. Si rrjedhojë kemi një rënie të financimeve. Gjithashtu 44 % e vlerës së financimit për periudhën objekt auditimi e kanë përfutur 4 subjekte, fakt ky i cili nuk reflekton rritje të numrit të kredi marrësve në dobi të NVM^{ve};

- Nuk është realizuar rritja e punësimit të grave dhe të rinjve mes NVM^{ve} përfutuese sepse nga programi i financimit PRODAPS janë krijuar mesatarisht 11 vende të reja pune për çdo financim, kurse nga programi i financimit IASME janë krijuar mesatarisht 6 vende të reja pune, nga financimet e monitoruara, pra krijimi i vendeve të reja të punës është në rënie krahasuar me programin PRODAPS. Gjithashtu nga ana e PMU/CLSC nuk ka një monitorim se sa gra dhe të rinj janë punësuar në këto vende pune të krijuara prej subjekteve të financuara nga programi;

- Nuk është realizuar rritja e NVM^{ve} shqiptare që përfitojnë certifikime të cilësisë (ISO 9001) dhe mjedisore (ISO 14001) pasi Njësia e Menaxhimit të Programit dhe Komiteti Drejtues i Kredive (PMU/CLSC) nuk kanë monitoruar sa subjekte të financuara nga programi janë pajisur me këto certifikata dhe nuk është dhënë asnjë ndihmë, asistencë teknike dhe konsulencë, për pajisjen e tyre me këto certifikata;

- Është realizuar pjesërisht rritja e huave nga ana e instituteve financiare pjesëmarrëse në dobi të NVM^{ve} që ndodhen jashtë korridorit Tiranë-Durrës. Për periudhën objekt auditimi, jashtë kësaj zone janë financuar 19 subjekte ose 76 % e totalit, ose 60 % e vlerës së financuar dhe 6 subjekte në zonën Tiranë-Durrës të cilat zënë një vlerë të konsiderueshme (40 % të vlerës së financuar). Gjithashtu nuk kemi një përfshirje të të gjitha zonave më pak të zhvilluar të vendit dhe për qarqet Vlorë, Kukës dhe Dibër nuk rezulton asnjë financim;

- Nuk është kryer nga ana e PMU/CLSC monitorim dhe vlerësim gjatë implementimit të programit si dhe mbledhje e të dhënave në mënyrë sistematike duke i renditur ato sipas një skeme të mirë përcaktuar të cilat janë shtylla kryesore për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e treguesve të matshëm.

- Nuk është analizuar raporti midis numrit të kredive mbi totalin e kredive të dhëna nga BTP dhe rritja në vlerën e shtuar të prodhimeve të përfutuesve.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 3, neni 5 dhe neni 14 si dhe Manuali Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga

CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 3, Kapitulli 4 dhe Kapitulli 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masa për organizimin e fushatave promociionale për të informuar bizneset në zonat e pa zhvilluara (kjo sipas parashikimeve të bëra në pikën 5.4.5 Aktivitetet Mbështetëse të Programit, germa c Promovimi i Komponentëve të Programit), të cilat nuk kanë akses në BTP për marrje kredie, për produktet financiare që ofron programi i financimit si dhe reklamimi i materialeve promociionale në qendrat dhe institucionet që kanë kontakte të drejtpërdrejta me publikun me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të Programit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.2 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masat e nevojshme për një monitorim dhe vlerësim të thelluar të të dy programeve, PRODAPS dhe IASME duke bërë të mundur evidentimin e pengesave të lindura, në të gjitha hallkat e procesit të kredithënies nga BTP, përgjatë implementimit të projektit që kanë ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të parashikuara në marrëveshje.

Menjëherë

4.3 Rekomandimi: CLSC/PMU në bashkëpunim me ekspertin e huaj të përcaktojnë tregues të matshëm dhe të verifikueshëm që do të bëjnë të mundur evidentimin e problematikave në realizimin e objektivave të programit në kohë reale gjatë implementimit të tij.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi 01.06.2017 deri më datën 30.04.2020 rezulton se: - Komponentët përbërës të kredisë nuk janë disbursuar brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje. Gjithashtu nga komponenti “Asistencë Teknike” nuk janë realizuar të gjitha parashikimet të cilat do të ndihmonin në realizimin e objektivave në tërësi të programit. - Fondi qarkullues, i krijuar nga rimbursimi i huas nga BTP, deri në datën 30.04.2020 është, nga programi PRODAPS 23,372,870.47 Euro dhe nga programi IASME 539,036.31 Euro. Nga ky fond me të njëjtin mekanizëm do të financohen projekte për NVM ndërmjet BTP bazuar në marrëveshjen “On Lending Agreement” në fuqi. Kostot e veprimtarisë, për elementët përbërës të “Asistencës Teknike”, të parashikuara në marrëveshjen e programit IASME janë për një periudhë tre vjeçare sipas afatit të disbursimit e përlogaritur mesatarisht 500,000 Euro/vit. Për sa i përket kohëzgjatjes së PRODAPS është 38 vjet, referuar nenit 4 të ligjit 9527 datë 11.05.2006 dhe për IASME është 16 vjet, referuar nenit 6 të ligjit 19/2014 datë 27.02.2014. Vihet re se të dy programet kanë një shtrirje në kohë që tejkalon planet e detajuara për menaxhimin e programit të parashikuara në marrëveshjet e financimit, e cila ka parashikuar të jetë 3 vjet. Nga ana e organeve drejtuese e menaxhuese të programit, MFE, CLSC, PMU dhe Njësive Lokale të huadhënësit nuk janë përgatitur plane financimi që do të mundësojnë menaxhimin e programit përgjatë kohëzgjatjes së parashikuar.

Situata e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 9, neni 10, neni 11 dhe neni 12, Shtojca 1 ‘Dokumenti i programit, përmbledhje dhe kuadri logjik’ pika 4 si dhe Manualin Operacional i zbatimit të projektit miratuar nga CLSC datë 18.07.2017 Kapitulli 5, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e një vendosjeje sa më të drejtë dhe të arritshëm të komponentëve të programit duke ju përshtatur nevojave të projektit përgjatë kohëzgjatjes të cilësuar në marrëveshje.

Në vazhdimësi

5.2 Rekomandimi: CLSC dhe PMU të organizojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Qeverinë Italiane (Huadhënësi) diskutime në lidhje me mundësinë e programimit të fondeve për mbulimin e veprimtarisë për administrimin e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes së parashikuar të tij, kjo për të shmangur mosfunksionimin e veprimtarisë së PMU si zbatuese e projektit përpara përfundimit të afateve në përputhje me parashikimet e cilësuar në marrëveshje.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi 01.06.2017 deri më datën 30.04.2020 rezulton se kontratat e punonjësve të PMU, për një periudhë prej të paktën 1 vit e gjysmë janë me afat 3 mujor në mënyrë të përsëritur. Punonjësit aktual kanë eksperiencë pune brenda këtij projekti dhe brenda të njëjtës PMU deri në 11 vite. Në fakt, duke qenë se programet PRODAPS dhe IASME janë parashikuar të jenë aktive deri në 38 vite (nisur nga viti 2008) dhe 16 vite (nga viti 2018), pra të paktën edhe 14 vite, në gjykim të grupit të auditimit një veprim i tillë jo vetëm që nuk i shërben objektivave të programit por gjithashtu nuk krijon mundësinë e një strukture të qëndrueshme dhe me staf gjithnjë e më të kualifikuar dhe të motivuar me qëllim përmbushjen e objektivave të vetë programit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 19/2014 “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Shqiptare” neni 5, paragrafi i parë si dhe neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: CLSC të marrin masa për shmangien e kontratave afatshkurtra të punës për stafin e PMU-së të cilat për të mundësuar një strukturë të qëndrueshme dhe motivuese për stafin dhe përmbushjen e objektivave të programit.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi menaxhimin financiar, nivelin e realizimit të disbursimeve rezultoi se Linja e kredisë, e alokuar në datë 30.04.2016 ka parashikuar një financim me shtrihej brenda 3 viteve në shumën prej 11,000,000 euro. Për periudhën objekt auditimi pra deri në 30.04.2020, rezulton të jetë disbursuar rreth 40 % e shumës totale të financimit edhe pse ka kaluar mbi 3 vjet nga koha e alokimit të fondeve. Nga ana e drejtimit të projektit për periudhën objekt auditimit, konstatohet se nuk janë marrë masat e duhura për të kryer parashikime dhe plane pune 3-mujore të miratuara për asnjë vit, nuk ka planifikim për nivelin e disbursimeve, me qëllim nxitjen, promovimin dhe zhvillimin financiar të projekteve, për të gjitha aktivitetet e kërkuara në përmbushje të përfundimit të programit dhe mbulimin e kostove të tyre, i cili të jetë i aprovuar nga Komiteti Drejtues i Kredisë. Këto veprime e mosveprime janë në mospërputhje me Manualin Operacional pasi, mungesa e një planifikimi të detajuar vjetor, në veçanti për nivelin e disbursimeve, nuk përmirëson

transparencën e një menaxhimi të shëndoshë financiar dhe nuk siguron një përdorim efektiv të burimeve të programit me qëllim arritjen e objektivave të projektit. Gjithashtu CLSC si një strukturë operative, nuk ka marrë masat e duhura për të kryer një mbikëqyrje mbi efikasitetin dhe eficiencën e Programit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Manualin Operacional Kapitulli 6, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 27-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë, të marrin masa që, programet vjetore të punës të PMU, të përmbajnë dhe plane periodike 3-mujore për të bërë të mundur mbikëqyrjen/monitorimin dhe matjen e realizimit të objektivave, si dhe përdorimin sa më efektiv të burimeve të programit.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të Kredi marrësve rezultoi se në të gjitha rastet, pra në 25 dosje të audituara, nuk rezultuan gjurmë të njoftimit nga banka e ndërmjetme drejtuar PMU, për kërkesën e subjekteve kredimarrëse. Gjithashtu, nuk është dërguar as dokumentacioni në formë fizike (hard copy) brenda afatit prej 5 ditësh. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Manualin Operacional pika 5.2, “Linja e Kredisë” ku thuhet se: *“PCB-të informojnë NjMP për secilën kërkesë për hua të marrë dhe transferojnë kopjet e të gjitha dokumenteve përkatëse të projektit brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas pranimit të secilës kërkesë.”* (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masa për plotësimin e 25 dosjeve të audituara me njoftimet e marra nga Bankat e Ndërmjetme për kërkesat për kredi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se në Manualin Operacional të Programit ka paqartësi në përcaktimin e dokumenteve justifikuese në lidhje me shpenzimet. Konkretisht, referuar Manualit Operacional, aneksit nr. 2 neni 4.7 dhe të Marrëveshjes On Lending thuhet se: ... *gjithë dokumentacioni i paraqitur në PMU duhet të jetë fotokopje e certifikuar nga banka, dhe në nenin 4.7: “BANKA është e detyruar të paraqesë në MFE, në PMU, 180 ditë (njëqind e tetëdhjetë) nga data e disbursimit të kredisë nga MFE tek banka, dokumentacionin përkatës (fotokopje të certifikuara nga BANKA) në lidhje me realizimin e projektit dhe shfrytëzimi i fondeve për qëllimet e përcaktuara me këtë kontratë.* Njëkohësisht, në Kapitullin 6 Menaxhimi Financiar, pika 6.4 Sistemi i Kontrollit Financiar, nën pika 6.4.1 Kontrolli i Brendshëm, paragrafi i dytë ku përcaktohet se: *“Kontrollet e brendshme kryesore për tu aplikuar për programin përfshijnë: Dokumente origjinale të kompletuara duhet të ekzistojnë për të mbështetur transaksionet e programit”.* Nga sa më sipër rezulton se janë paraqitur si kriter për justifikimin e shpenzimeve të fondeve të Programit, dy mundësi të kundërta me njëra tjetrën, nga njëra anë fotokopje të certifikuara nga Banka e Ndërmjetme, kur në fakt Bankat nuk janë një organ i tillë certifikues e nga ana tjetër janë kërkuar që dokumentet justifikuese duhen origjinale. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Manualin Operacional, Kapitulli 6 Menaxhimi Financiar, pika 6.4 Sistemi i Kontrollit Financiar, nën pika 6.4.1 Kontrolli i Brendshëm, paragrafi i dytë ku përcaktohet se: *“Kontrollet e brendshme kryesore për tu aplikuar për programin përfshijnë: Dokumente origjinale të kompletuara duhet të ekzistojnë për të*

mbështetur transaksionet e programit” si dhe Manuali Operacional, aneksi nr. 2 neni 4.7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masa të azhurnojnë Manualin Operacional duke përfshirë në këtë material si kusht, përdorimin vetëm të materialeve origjinale në lidhje me argumentimin e shpenzimeve dhe të shmangin praktikat e certifikimit nga ana e Bankave të Ndërmjetme të materialeve fotokopje.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste ndaj Bankave të Ndërmjetme nuk janë aplikuar penalitetet në shumën **38,520 €** për mangësitë e konstatuara përgjatë dosjeve të kredive të dhëna ndaj subjekteve kredimarrëse sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Marrëveshjen “*On – lending agreement*”, artikulli 4.7 përcaktohet se: “*Banka e Ndërmjetme është e detyruar ti paraqesë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, PMU – së, 180 ditë nga data e disbursimit të kredisë nga Ministria tek Banka e Ndërmjetme, dokumentacionin përkatës lidhur me realizimin e projektit dhe përdorimin e fondeve për çështjet e trajtuara në këtë kontratë*” si dhe Artikulli 3.1, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masat e duhura për arkëtimin e shumës prej **38,520 €** nga Bankat sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.2, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit nëpërmjet aplikimit të penaliteteve ndaj Bankave të Ndërmjetme.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE TË PROGRAMIT DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË LINJËS SË KREDISË.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera me anë të bankës u konstatua se me urdhër transfertën e datës 23.10.2017 është likuiduar fatura me nr. 1332, datë 16.10.2017 ndaj studios O. L. & F. me përfitues I. D. në shumën 1,800 €. Ky shpenzim është kryer për përgatitjen e përgjigjeve të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me argumentimin ligjor të penalitetit për kthimin e shumës së kredisë përpara afatit nga subjekti “M. ShPK”. Shuma e likuiduar prej **1,800 €** është e pa argumentuar dhe e pa bazuar ligjërisht dhe përbën shpenzime të panevojshme për NJMP-në. Me urdhër transfertën e datës 05.09.2017 janë likuiduar fatura me nr. 1924, datë 23.08.2017 me shumë 1,200 € me TVSH dhe fatura me nr. 1301, datë 31.08.2017 me shumë 1,800 €, pra në total është likuiduar shuma prej 3,000 € e cila është shpenzim i panevojshëm për NJMP-në. Të dyja shpenzimet e mësipërme në shumën 4,800 € janë veprime në mospërputhje me Manualin Operacional Kapitulli 6, pika 2 pasi nuk i shërbejnë qëllimit dhe objektivit të linjës së kredisë. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Manualin Operacional (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 27-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masa që për periudhën deri në përfundim të programit shpenzimet për konsulencë ligjore dhe teknike të kryhen për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të programit, për përdorimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 5 raste nuk janë marrë masa për evidentimin e mangësive dhe më pas kthimin pas të shumës së mbetur nga kreditë e dhëna në shumën totale prej **1,234,000 €** për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se:

11. Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme F. B. tek Klienti B. A. I. (shuma për kthim në masën 500,000 €)

- Nuk konfirmohet origjina italiane për 7 furnitorë të Klientit;
- Për 5 furnitorë (nga këta 7 si më sipër) nuk konfirmohen dokumentet e zhdoganimit të materialeve;

12. Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme C. tek Klienti I. N. F. (shuma për kthim 500,000 €)

Nga të gjitha shpenzimet justifikuese rezulton se me shkresën e administruar në PMU me nr. 36 prot., datë 05.05.2020 janë dorëzuar:

- Faturat tatimore;
- Deklaratat për zhdoganimin e makinerive dhe pajisjeve;
- Swift pagesat në shumën 200,000 €;
- Swift pagesat në shumën 300,000 €;

Materialet e mësipërme rezulton se janë sjellë përtej afati 18 muaj nga data e disbursimit të kredisë.

13. Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. G. (shuma për kthim 50,000 €)

- Deri në fund të afatit të parashikuar në marrëveshjen “*On lending Agreement*” nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit justifikues të pagesës së kryer në favor të Klientit.

14. Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme T. B. tek Klienti E. (shuma për kthim 164,000 €)

- I gjithë investimi i kryer, referuar faturave dhe deklaratave doganore për blerjen e makinerive në shumën 135,520 Euro, e ka me origjinë Zvicerane dhe jo me origjinë Italiane, dhe blerja e makinerive dhe pjesëve është bërë në Zvicër dhe jo sipas parashikimeve të bëra në marrëveshjen “*On lending Agreement*”;

15. Në lidhje me financimin nga Banka e Ndërmjetme I. S. P. tek Klienti A. D. (shuma për kthim 70,000 €)

- Një prej faturave tatimore në shumën 66,790 € përmban shpenzime në shumën 16,667 € për blerje të kryera përpara datës së disbursimit të kredisë dhe si e tillë nuk duhet të merret në konsideratë si justifikim për fondet e Programit;
- Një prej faturave tatimore me vlerë 999,810 lekë ose 7,680 € është përdorur për mbulimin e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit;
- Një prej faturave tatimore me vlerë 960,000 lekë është përdorur për mbulimin e detyrimeve të lindura përpara disbursimit të kredisë nga fondet e Programit;

Situata e mësipërme është në kundërshtim me Marrëveshjen “*On – lending agreement*”, artikulli 7.5 përcaktohet se: “*Në rast të konstatimit të shkeljes nga ndonjë prej kritereve të pranueshmërisë, Banka e Ndërmjetme duhet rimbursojë të gjithë shumën e kredisë për MFE*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrë masa për respektimin e kriterëve të vendosura në lidhje me praktikën e dhënies së kredive dhe kthimin pas të shumave të tyre në rastet e shkeljes së kushteve të Marrëveshjes On Landing Agreement me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e Programit siç është rasti i mësipërm për 5 subjektet në shumën **1,234,000 €** sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.3, faqe 56 e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të Kredi marrësve rezultoi se në **11 raste** janë financuar nga Programi shuma prej **1,114,134 €** sipas listës së përshkruar në Aneks 5.4, faqe 46 e Raportit Përfundimtar të Auditimit për subjekte kredi marrës të cilësuar si *Mikrondërmarrje*, kur në fakt objekt financimi i këtij Programi kanë qenë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – të). Sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshjen e Financimit Mikrondërmarrjet, Ndërmarrjet e Vogla dhe ato të Mesme klasifikohen si të tilla në bazë të numrit të punëtorëve, përkatësisht, 1-9, 10-49 dhe 50 – 249. Në fakt rezultoi se për këto 11 subjekte shuma e mësipërme prej 1,114,134 € është përdorur për të financuar projekte për ndërmarrje me 1-9 të punësuar. Konkretisht lista e këtyre subjekteve paraqitet sipas tabelës së përshkruar në Aneksin 5.4, faqe 56 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me: **a.** Ligjin nr. 8957, datë 17.10.2002 *“Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”*, i ndryshuar me ligjin nr. 10042 datë 22.12.2008, në nenin 4, Ligjin nr. 19/2014 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Realizimin e “Programit të Ndhmës së Integruar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Shqiptare”*, neni 1 Përmbajtje dhe përkufizime të Marrëveshjes, pika 1.3 Fjalët dhe shkurtime të renditura më poshtë kanë kuptimet sikurse vijon, paragrafi i katërmëdhjetë, neni 3 Përshkrimi i Programit, paragrafi i tretë si dhe Shtojca 1, paragrafi i katërt. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masa për financimin e Projekteve të Kredi marrësve që janë objekt i Marrëveshjes së Financimit, konkretisht Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe jo Mikrondërmarrjet me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të Programit siç është ai i 11 Projekteve me shumë totale **1,114,134 €** të përshkruar sipas tabelës në Aneks 5.4, faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në 22 raste janë aplikuar nga Bankat e Ndërmjetme komisione për kryerjen e shpenzime bankare, apo komisione për disbursimin e kredisë në përqindje të ndryshme të cilat variojnë nga 0.5 % deri në 10 %. Në fakt këto janë aplikuar në dëm të Klientëve në kundërshtim me marrëveshjen On Lending Agreement pasi këto komisione janë marrë përsipër nga Banka e Ndërmjetme e si të tilla janë detyrim i tyre dhe jo i kredimarrësve. Për rrjedhojë rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet shuma prej të paktën **31,070 €** dhe **798,750 lekë** të fondeve të Programit nga ana e Bankave sipas tabelës së përshkruar në Aneksin nr. 5.1, faqe 55 – 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Situata e mësipërme është në kundërshtim me Marrëveshjen *“On – Lending Agreement”*, artikulli 13 përcaktohet se:

13.1 “Banka e Ndërmjetme është e detyruar të paguajë, nëse ka, të gjitha taksat, detyrimet apo çdo obligim tjetër që ka të bëjë me këtë kontratë”;

13.2 “Banka e Ndërmjetme mbart të gjitha shpenzimet për shërbimet, shpenzimet bankare, transfertat dhe shpenzimet e konvertimit që mund të ndodhin bazuar në firmosjen dhe realizimin e kontratës në fjalë apo çdo dokumenti tjetër të lidhur me këtë kontratë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: CLSC/PMU të marrin masat e duhura për shmangien e aplikimeve të komisioneve të tilla në ngarkim të kredimarrësve siç janë ato të shumave prej **31,070 €** dhe **798,750 lekë** nga Bankat e përshkruara sipas tabelës në Aneks 5.1, faqe 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim përdorimin e fondeve të Programit vetëm për përmbushjen e objektivave të parashikuara në marrëveshje.

Në vazhdimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

D.I Mbështetur në konkluzionet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit i rekomandojmë Kryetarit të Bordit të CLSC të fillojë procedurat për analizimin e shkeljeve dhe nxjerrjen e përgjegjësi për personat në cilësinë e anëtarëve të këtij Bordi, sipas periudhave përkatëse, në lidhje me:

- Mos marrjen në konsideratë të të gjitha rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Mos marrjen e masave të nevojshme me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të CLSC/PMU në lidhje me monitorimin e realizimit të objektivave dhe komponentëve të Programit;
- Mos marrjen e masave të nevojshme me qëllim pranimin vetëm të projekteve objekt i Marrëveshjes së Financimit (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme) ku për rrjedhojë ka rezultuar se janë financuar Projekte për 11 Mikrondërmarrje, në total në shumën prej **1,114,134 €**.

D.II Mbështetur në Kontratën individuale të punës, neni 17 ‘Raste të tjera të zgjidhjes së kontratës dhe zgjidhja e menjëhershme nga punëdhënësi’, lidhur ndërmjet Komiteti Drejtues të Linjës së Kredisë/CLSC dhe Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Programit për Projektin ‘Zhvillimi i Sektorit Privat’, i kërkojmë CLSC, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Largim nga puna**”, për personat si më poshtë:

1. Z. G. L. me detyrë Drejtor i Njesisë së Menaxhimit të Programit, pasi:

- Në fillim të auditimit në terren janë shkaktuar vonesa prej datës 04.05.2020 deri me datë 14.05.2020 për ecurinë normale të punës audituese, duke e vështirësuar akoma më tepër situatën pas vonesave të krijuara prej vetë pandemisë së COVID 19. Konkretisht, referuar shkresës së administruar në MFE me nr. 4816/16 datë 08.05.2020 dhe administruar në KLSH me nr. 287/3 prot., datë 19.05.2020 janë paraqitur edhe pretendimet në lidhje me mungesën e kompetencave të KLSH për të audituar këtë Projekt. Në vijim, në rrugë elektronike me datë 13.05.2020, është komunikuar miratimi nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MFE për të vijuar me punën audituese;
- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të PMU në lidhje me monitorimin e realizimit të objektivave dhe komponentëve të Programit;
- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim shmangien e pagesave në formën e komisioneve bankare për 22 raste nga ana e Klientëve Kredimarrës në

shumat prej **31,070 €** dhe **798,750 lekë**, veprim ky në kundërshtim me Manualin Operacional dhe Marrëveshjen On Lending Agreement;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim plotësimin e dokumentacionit të Bankave të Ndërmjetme sipas kërkesave të Manualit Operacional dhe Marrëveshjes On Lending Agreement e duke mos aplikuar kështu penalitetet për 5 raste në shumën **38,520 €**;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim kthimin pas të shumave të mbetura të kredive për 5 raste në vlerën totale prej **1,234,000 €** për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim pranimin vetëm të projekteve objekt i Marrëveshjes së Financimit (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme) ku për rrjedhojë ka rezultuar se janë financuar Projekte për 11 Mikrondërmarrje, në total në shumën prej **1,114,134 €**;

D.III Mbështetur në Kontratën individuale të punës, neni 18 ‘Masa Displinore’ lidhur mes Drejtorit të Njësisë së Menaxhimit të Programit/PMU dhe Financierit e Specialistit të Projektit i kërkojmë CLSC/PMU, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “Vërejtje me shkrim” për personat si më poshtë:

1. Znj. B. J. me detyrë Financiere e Programit;

2. Znj. E. M. me detyrë specialiste e Programit pasi:

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk kanë marrë masat e nevojshme me qëllim plotësimin e dokumentacionit të Bankave të Ndërmjetme sipas kërkesave të Manualit Operacional dhe Marrëveshjes On Lending Agreement e duke mos aplikuar kështu penalitetet për 5 raste në shumën **38,520 €**;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim shmangien e pagesave në formën e komisioneve bankare për 22 raste nga ana e Klientëve Kredimarrës në shumat prej **31,070 €** dhe **798,750 lekë**, veprim ky në kundërshtim me Manualin Operacional dhe Marrëveshjen On Lending Agreement;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim kthimin pas të shumave të mbetura të kredive për 5 raste në vlerën totale prej **1,234,000 €** për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion;

- Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim pranimin vetëm të projekteve objekt i Marrëveshjes së Financimit (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme) ku për rrjedhojë ka rezultuar se janë financuar Projekte për 11 Mikrondërmarrje, në total në shumën prej **1,114,134 €**;

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

1. z. K. B.

Për ish punonjësën e mësipërm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi i sipërpërmendur nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga **“Largim nga puna”**.

V. ANEKSE

Aneksi 1.1

Të dhëna mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të pa pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Përmirësime ligjore	-	-					
Masa organizative	13	12	1	5	5	-	3
Masa shpërbllim dëmi	-	-	-	-	-	-	-
M.D.ekonomik pamundësi arkëtimi	-	-	-	-	-	-	-
Masa për elimin.....	7	7	3	4	-	-	3
Masa disiplinore	2	2	-	2	-	-	-
Totali	22	21	4	10	5	-	7
Totali në %		95 %	18 %	45 %	23 %	-	32 %

Masa Organizative

1.1 Rekomandimi: Nga Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) dhe Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë (CLSC) të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke i trajtuar ato në vazhdimësi deri në përfundim të projektit. Në rast moszbatimi të rekomandimeve, KLSH do të denoncojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mosveprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi nga auditimi rezultoi se nga 13 Masa Organizative, 7 për përdorim pa EEE dhe 2 Masa Disiplinore të rekomanduara nga auditimi i mëparshëm (22 në total):

- janë realizuar 4 Masa Organizative, 4 për përdorim pa EEE dhe 2 Masa Disiplinore;
- janë zbatuar pjesërisht 5 Masa Organizative;
- nuk janë zbatuar 4 masa organizative dhe 3 masa për eliminimin e efekteve negative në shumën 14,044 €.

2.1 Rekomandimi: Duke konsideruar faktin se nga ana e PMU, administrimi i dosjeve të kredive është kryer në përputhje me marrëveshjen e pretenduar të ndryshuar, në vazhdimësi të plotësohen të gjitha dosjet me dokumentet e kërkuara në marrëveshjen e ratifikuar me Ligjin nr. 9527, datë 11.05.2006 “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihme”.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Në të ardhmen, për sa i përket aplikimit të ndryshimit të marrëveshjeve të ratifikuara në parlament, PMU/MZHETS të sigurohen që nga ana e organeve kompetente përkatëse të jetë ezauruar procedura për protokollin ndryshues në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi.

Në vijimësi

Këto rekomandime nuk janë zbatuar pasi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ndryshimet e marrëveshjes të Ligjit nr. 147/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së

financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe A. s.p.a. për financimin e Programit të Ndhmës së Integruar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare”, janë miratuar në parim nga Kryeministri por akoma nuk janë miratuar konform ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandimi 3.1: PMU/CLSC të analizojnë situatën e krijuar, duke marrë masa për përmirësimin e treguesve në lidhje me bashkëpunimin me bankat tregëtare partnere si dhe të rishikojë vazhdimësinë e marrëveshjes on - lending me bankat jo aktive.

Gjithashtu nga PMU/CLSC të merren masa të menjëherëshme për hartimin dhe zhvillimin e fushatave informuese dhe sensibilizuese në lidhje me kushtet lehtësuese të projektit, me qëllim pjesëmarrjen sa më të gjerë të bizneseve të vogla dhe të mesme në projektin “Zhvillimi i sektorit privat”, duke u fokusuar në zonat jashtë aksit Tiranë-Durrës ku aktualisht nuk ka shumë përfitues dhe informimi është minimal.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jetë kryer një analizë nga ana e PMU/CLSC në lidhje me situatën e krijuar, marrjen e masave për përmirësimin e treguesve si dhe rishikimin e marrëveshjes On – Landing me bankat jo aktive. Gjithashtu, nuk dokumentohet marrja e masave të menjëhershme në lidhje me hartimin dhe zhvillimin e fushatave informuese dhe sensibilizuese me fokus në zonat jashtë aksit Tiranë – Durrës. Për sa më sipër rezulton se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Rekomandim 4.1: Në vazhdimësi, PMU të përcaktojë objektiva vjetorë për disbursimin e linjës së kredisë, të cilat duhet të miratohen nga ana e CLSC dhe të shërbejnë si njësi matëse për përmbushjen e objektivave dhe efektivitetin e kësaj njësie në zbatimin e objektivit kryesor të projektit, atë të disbursimit të sa më shumë projekteve të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Në vijimësi

Ky rekomandim nuk është zbatuar.

Rekomandim 5.1: Nga ana e PMU/CLSC të merren masa për aktivizimin sa më të shpejtë të fondeve të linjës së kredisë të marrëveshjes ISAME dhe vënien në efikasitet të plotë të tyre, në mënyrë që këto fonde të mos shërbejnë vetëm për mbulim shpenzimesh, por për qëllimin kryesor të kësaj marrëveshjeje, atë të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Në vazhdimësi PMU të sigurohet që pasqyrat financiare, të jenë të miratuara nga organet kompetente, si një kusht i nevojshëm për dhënien e një sigurie të arsyeshme për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në nenin 3 pika 2 të marrëveshjes On Lending, për sa i përket qarkullimit vjetor.

Në vijimësi

6.2 Rekomandimi: Gjithashtu nga PMU të merren masa që të pranohen vetëm ato fotokopje dokumentash të cilat janë të vullosura nga ana e bankës, në përputhje me pikën 11.1 të

marrëveshjes on-lending. Veprim i cili do të rrisë besueshmërinë e dokumentit të dorëzuar nga ana e subjekteve përfitues të linjës së kredisë.

Në vijimësi

Këto rekomandime janë zbatuar.

7.1 Rekomandimi: Në vazhdimësi nga PMU të mos pranohen plane biznesi fiktive, ku nuk ka asnjë përshkrim të saktë të investimit. Në planin e biznesit, krahas preventivave, duhet të jetë përshkruar impakti që mendohet të ketë materializimi i këtyre investimeve, si rritja e biznesit dhe numrit të punonjësve, duke shërbyer gjithashtu si indikatorë të arritjeve të projektit.

Në vijimësi

Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

8.1 Rekomandimi: Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të projektit “Zhvillimi i sektorit privat”, në zbatim të Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në mbështetje të Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

9.1 Rekomandimi: Komiteti Drejtues i Kredive dhe Njësia e Menaxhimit të Programit të marrin masa që në Manualin Operacional të reflektohen kushtet e ndikimit në mjedis, në mënyrë që ky ndikim të paraqitet nga NMV-të dhe projektet që ato paraqesin për marrjen e kredive.

Menjëherë

Ky rekomandim nuk është zbatuar.

10.1 Rekomandimi: Njësia e Menaxhimit të Projektit, në vazhdimësi të plotësojë me dokumenta justifikues impaktin e investimeve në lidhje me rritjen e numrit të punonjësve, duke qenë një nga objektivat kryesor të projektit, i cili duhet të ketë një impakt pozitiv në uljen e numrit të papunësisë.

Në vijimësi

Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nga ana e PMU është mbajtur dokumentacioni i cili raporton në lidhje me ndryshimet në numrin e të punësuarve por nga ana tjetër ky numër nuk ka arritur në rritje çka do të thotë se nuk është arritur një ndër objektivat e programit.

11.1 Rekomandimi: PMU të marrë masa për verifikimin ex post të financimit për ato projekte të cilat janë financuar, si dhe në bashkëpunim me CLSL, në Manualin Operacional të reflektohen afate kohore fikse dhe të arsyeshme për realizimin e monitorimit të investimit.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se jo në të gjitha rastet janë kryer verifikime ex post të subjekteve të financuara.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve të projektit dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

1.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankave. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penalitetit të shumës 53,710 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

2.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankave. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penalitetit të shumës 39,500 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi nuk është bërë arkëtimi i penalitetit ndaj subjektit “F. M.” Banka C. në shumën 2,600 €.

3.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankave. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penalitetit të shumës 34.319 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi nuk është bërë arkëtimi i penalitetit ndaj subjektit “E.” T. Bankë në shumën 6,444 €.

4.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankave. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penalitetit të shumës 4,100 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankës. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penalitetit të shumës 5,000 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi nuk është bërë arkëtimi i penalitetit ndaj subjektit “B.” U. Bankë në shumën 5,000 €.

6.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankës. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha

procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penaltetit të shumës 48,500 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

7.1 Rekomandimi: Nga PMU/CLSC të merren masa konkrete për vendosjen e një afati të pranueshëm për plotësimin e dokumentacionit nga ana e bankës. Në rast mosplotësimi të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues brenda afatit të maturimit të kredisë, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ligjore për kthimin pas të vlerës së mbetur të kredisë dhe arkëtimit të penaltetit të shumës 25,000 Euro nga ana e bankës.

Menjëherë

Ky rekomandim është zbatuar.

Për sa i përket rekomandimeve të lëna në lidhje me arkëtimin dhe/ose plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjet “F. M.” Banka C., “E.” T. Bankë dhe “B.” U. Bankë, këto masa janë në axhendën e ardhshme të mbledhjes së Bordit të CLSC por aktualisht, nga data 26.06.2017 datë në të cilën është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit si dhe Rekomandimet përkatëse, deri në datën në të cilën mbahet ky akt konstatimi, nuk rezulton të jenë marrë masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve.

Masa Disiplinore

Mbështetur në nenin 37, 141, 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9527 datë 11.05.2006 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe ligji 19/2014 datë 27.02.2014 marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës 14 Italiane për realizimin e programit për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri, i kërkojmë Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të projektit (PMU) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (ish MZHETS), të analizojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit duke vlerësuar dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në këtë Raport.

Ky rekomandim është zbatuar.

Aneksi 5.1

Lista e Subjekteve Bankare dhe shumat përkatëse për arkëtim

Nr.	Banka	Klienti	Shuma
1	C.	I. N. F.	5,000 €
2	I. S. P.	C.	2,488 €
3	C.	T. K.	4,300 €
4	C.	R.	385 €
5	C.	G. SH.	470,000 lekë
6	I. S. P.	D. – P. A.	1,513 €
7	I. S. P.	A. G.	500 €
8	C.	S. B.	93,750 lekë
9	C.	E. T.	314 €
10	C.	O. XH.	245 €
11	I. S. P.	A.	2,000 €
12	T. B.	E.	820 €
13	N.	G. J.	4,700 €

14	N.	B. & N.	2,500 €
15	C.	A. R.	25,000 lekë
16	C.	P. M. GJ.	2,000 €
17	C.	O. H.	1,955 €
18	C.	G. D.	300 €
19	C.	F. B.	210,000 lekë
20	I. S. P.	A. D.	700 €
21	I. S. P.	N. K.	1,140 €
22	N.	A. M.	210 €
TOTAL			31,070 €
			798,750 lekë

Aneksi 5.2

Lista e Subjekteve Bankare dhe shumat përkatëse në formën e penalitetit për efekt të mangësive në dokumentacion.

Nr.	Banka	Shuma
1	F. B.	15,000 €
2	C.	15,000 €
3	I. S. P.	1,500 €
4	T. B.	4,920 €
5	I. S. P.	2,100 €
TOTAL		38,520

Aneksi 5.3

Lista e subjekteve për kthimin e shumës së mbetur kredisë.

Nr.	Banka	Klienti	Shuma
1	F. B.	B. A. I.	500,000 €
2	C.	I. N. F.	500,000 €
3	I. S. P.	A. G.	50,000 €
4	T. B.	E.	164,000 €
5	I. S. P.	A. D.	70,000 €
Zbritet vlera e Subjektit A. G.			50,000 €
TOTAL			1,234,000

Sqarim: Vlera e subjektit A. G. është zbritur pasi kjo vlerë prej 50,000 € është konsideruar një herë si e përdorur pa Efektivitet, Eficiencë dhe Ekonomicitet në gjetjen nr. 1 për efekt të financimit si Mikrondërmarrje.

Aneksi 5.4

Lista e subjekteve Kredimarrëse në formën e Mikrondërmarrjeve

Nr.	Banka	Klienti	Numri i të punësuarve	Shuma
1	U. B.	G. D.	2	30,000 €
2	I. S. P.	A. G.	1	50,000 €
3	C.	F. B.	7	167,300 €
4	N.	G. J.	2	47,000 €
5	N.	A. M.	2	21,000 €
6	C.	O. XH.	1	24574 €
7	C.	G. SH.	6	382,830 €
8	N.	B. & N.	5	25.000 €
9	C.	A. R.	2	19,930 €
10	C.	O. H.	3	195,500 €
11	U. B.	A. E.	3	151.000 €
TOTAL				1,114,134

Aneksi 5.5**Lista e subjekteve të financuara nën Programin IASME**

Nr.	Dosja nr.	Banka	Kredi marrësi	Lloji i Kompanisë	Data e Disbursimit	Shuma (euro)	Interesi	Periudha e Pagesës	Periudha e Faljes
IASME									
1	115	U. B.	A. E. shpk	shpk	7-Aug-17	151,000.00	3	96	12 muaj
2	116	C.	O. H.	Person Fizik	8-Aug-17	195,500.00	4	96	3
3	117	U. B.	G. D.	Person Fizik	16-Oct-17	30,000.00	3	96	n/a
4	118	C.	E. T.	shpk	15-Dec-17	31,430.00	3	48	
5	119	T. B.	E. shpk	shpk	22-Dec-17	164,000.00	3	72	0
6	120	I. S. P.	A. G.	Person Fizik	16-Mar-18	50,000.00	3	48	12
7	121	C.	T. K.	shpk	1-Jun-18	430,000.00	3	84	n/a
8	122	F. B.	B. A. I.	shpk	1-Jun-18	500,000.00	1	96	2
9	123	C.	F. B.	Person Fizik	3-Sep-18	167,300.00	4	96	0
10	124	I. S. P.	A.	shpk	19-Oct-18	200,000.00	3	84	12 muaj
11	125	I. S. P.	A. D.	Person Fizik	15-Nov-18	70,000.00	4	84	n/a
12	126	F. I.	E. T. sh.p.k	sh.p.k	27-Dec-18	18,370.00	3	48	n/a
13	127	N.	G. J.	Person Fizik	8-Jan-19	47,000.00	3	60	n/a
14	128	C.	S. B.	Person Fizik	4-Mar-19	75,000.00	4	60	n/a
15	129	F. I.	E. T. sh.p.k/ 2nd p.	sh.p.k	8-May-19	15,000.00	3	48	n/a
16	130	C.	R.	shpk	22-Jul-19	385,000.00	3	60	n/a
17	131	C.	I. N. F.	shpk	29-Oct-19	500,000.00	3	60	5 muaj
18	132	I. S. P.	N. K./ 2nd p.	Person Fizik	31-Oct-19	124,000.00	3	96	N/A
19	133	N.	A. M.		19-Dec-19	21,000.00	3	60	n/a
20	134	C. B.	O. Xh.	Person Fizik	4-Feb-20	24,574.00	4	84	n/a
21	135	I. S. P.	D. P. al	shpk	11-Feb-20	302,600.00	3	60	n/a
22	136	C. B.	G. sh.	shpk	9-Mar-20	382,830.00	4	72	n/a
23	137	I. S. P.	C. shpk	SHPK	11-Mar-20	497,600.00	3	84	n/a
24	138	N.	B. and n.	shpk	11-Mar-20	25,000.00	3	60	n/a
25	139	C.	A. R.	pf	21-Apr-20	19,930.00	4	60	n/a
					IASME	4,427,134.00			

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT